



UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

**Vepra penale e dhunimit në rrethin e Gjykatës Themelore në Tetovë
për periudhën 2012-2017**

Mentor:

Prof. Dr. Ismail Zejneli

Kandidat:

Besijana Velija

Tetovë, 2018

Strukturimi i punimit

-Hyrje

-Arsyetimi i punimit

-Metodat hulumtuese

KAPITULLI I PARE

1. **Nocioni i veprës penale të dhunimit**.....
2. Trajtime historike lidhur me veprën penale të dhunimit.....
3. Aspekte krahasimore të veprës penale të dhunimit.....
 - 3.1.Aspekte krahasimore me R.Kosovës.....
 - 3.2. Aspekte krahasimore me R.Shqiperisë.....
4. Përgjegjësia juridiko-penale e kryerësve të veprave penale të dhunimit.....

KAPITULLI I DYTË

1. **Format e veprës penale të dhunimit**.....
 - 1.1.Vepra penale e dhunimit.....
 - 1.2. Vepra penale e dhunimit me persona nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.....
 - 1.3. Vepra penale e dhunimit me persona me çrregullime ose paaftësi mendore.....
2. Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin.....
3. Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës.....
4. Marrëdhëniet seksuale brenda familjes.....

KAPITULLI I TRETE

1. **Kryerësit e veprave penale të dhunimit**.....
- 1.1. Moshë e kryerësve të veprës penale të dhunimit.....
- 1.2. Gjinia e kryerësve të veprës penale të dhunimit.....
- 1.3. Rrethi familjar i kryerësve të veprës penale të dhunimit.....
- 1.4. Niveli i arsimorit të kryerësve të veprës penale të dhunimit.....
- 1.5. Përgatitja shkollore e kryerësve të veprës penale të dhunimit.....
2. **Viktimat e veprave penale të dhunimit**.....
- 2.1. Moshë e viktimave të veprës penale të dhunimit.....
- 2.2. Gjinia e viktimave të veprës penale të dhunimit.....
- 2.3. Rrethi familjar i kryerësve të veprës penale të dhunimit.....
- 3.3. Përgatitja shkollore e viktimave të veprës penale të dhunimit.....

KAPITULLI I KATERT

1. **Luftimi dhe Parandalimi i veprave penale të dhunimit**.....
2. Roli i policisë në parandalimin e veprave penale të dhunimit.....
3. Roli i prokurorisë së shtetit në parandalimin e veprave penale të dhunimit.....
4. Roli i gjykatave në parandalimin e veprave penale të dhunimit.....
5. Roli i Qendrës për Punë Sociale në parandalimin e veprave penale të dhunimit.....

- Hyrje

Objekt studimi në këtë punim është vepra penale e dhunimit si veper ne kuader te veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 2012–2017. Hulumtimi i punimit te masterit lidhur me vepren penale të dhunimit është i kufizura sikurse në aspektin e territorit poashtu edhe në aspekt të kohes, së studimit pra për periudhën pesë vjeçare.

Dhuna seksuale, dhuna mbi përkatësinë gjinore dhe dhuna ndaj femrave janë termine, të cilat gjatë përdorimit, shpesh tregojnë të njëjtën çështje. Të gjitha këto shprehje i takojnë shkëljes së të drejtave themelore të njeriut, duke i shtuar jetë roleve të stereotipeve, të bazuara në gjininë e individit dhe, në këtë mënyrë, individët i zhveshin nga dinjiteti njerëzor dhe vetëvendosja, duke penguar kështu zhvillimin njerëzor në përgjithësi.

Në ligje janë përfshirë konceptet bashkëkohore lidhur me të drejtën e njeriut që të vendosi lirisht për jetën e tij seksuale, respektivisht për dinjitetin dhe integritetin seksual.

Shkenca juridiko-penale gjithnjë e më shumë është fokusuar tek politika penale specifike për evidentim, parandalim, rehabilitim dhe ndëshkim të viktimizimit seksual. Ky lloj krimi karakterizohet nga element social dhe psikologjik.

Qëllimi i trajtimit të vepres penale te dhunimit, si një akt i rende per jeten e viktimes, nuk eshte i trajtuar sa duhet, dhe besoj se ky punimi do te jep nje kontribut te vogel ne shkence.

Veçanërisht do të hulumtojmë moshën e kryerësve të veprës penale të dhunimit, pregatitjen shkollore, rrethin ku jetojnë, profesionin e tyre, gjendjen e tyre materiale, etj.

Poashtu do të hulumtohet mosha e viktimave të veprës penale të dhunimit, gjinia e viktimave, statusi social, përkatësia kombëtare, raportet e viktimave me kryerësin etj.

Gjatë vështirimit dhe analizimi të lëndëve penale të krimeve seksuale, do të analizohet politika ndëshkuese e gjykatës themelore për veprën penale të dhunimit gjatë viteve të studimit-2012-2017.

Me qenëse kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje, kryerës të veprave penale të dhunimit janë personat e përgjëgjshëm penalisht të cilët në momentin e kryerjes së veprës penale kanë qenë të vetëdijshëm për veprimin që e kryejnë dhe kanë kuptuar rëndësinë e veprës penale, si dhe kanë pasur aftësi për të udhëhequr me veprimet e tyre.

Poashtu do të hulumtohen edhe rastet kur si kryerës të veprës penale të dhunimit paraqiten personat me devijime asociale sic janë; homoseksualizmi, pedofilia, incesti, sadizmi seksual etj.

- Arsyeshmëria e punimit

E drejta penale bashkëkohore në decenien e fundit ka pësuar ndryshime të mëdha lidhur me sferën e jetës seksuale. Legjislacionet penale më të hershme kanë inkriminuar dhe sanksionuar një numër të sjelljeve të kësaj sfere, pa marr parasysh se kush është kryerësi i veprës penale të dhunimit.

Kështu, kohë pas kohe kanë ndryshuar qëndrimet dhe sanksionet lidhur me sjelljet e caktuara të kësaj sfere të jetës intime.

Sot kjo temë është shumë aktuale sepse nuk ka shumë punimi të prezantuar dhe të botuar në Tetovë dhe më gjerë, prandaj mendoj që do të ishte në interes të veçantë hulumtimi dhe trajtimi i kësaj teme.

- Metodologjia e hulumtimit

Duke u nisur nga shkaku se trajtimi i çështjes së veprës penale-dhunimit është një temë sa specifike aq edhe komplekse është e domosdoshme aplikimi i një metodologjie adekuate e cila do të ndihmojë ta vërtetojmë hipotezën kryesore dhe ndihmëse. Në këtë kuptim si të domosdoshme e konstatojmë metodën e **analizës, intervistes, metoda komparative dhe statistikore, historike**,përmes së cilës mendojme te realizojme ne plotni te gjitha objektivat e parashtruara te ketij punimi.

Metoda statistikore

Gjatë këtij studimi do të shërbehem me metodën statistikore që do ti studioj-analizoj të dhënat statistikore që do ti siguroj ne Gjykatën themelore në Tetovë, port ë dhëna nga Enti statitikor i Republikës së Maqedonisë. Me një analizë empirike do të na mundësohet që në mënyrë të përshtatshme të bëjë mbledhjen dhe përcjelljen e shumë të dhënave mbi dhunimin shume dhe mbi kriminalitetin që lidhen me veprat penale kundër integritetit seksual.

Metoda e intervistës

Do të marim intervista me viktimat e dhunimit, për periudhën e studimit dhe ne teritorin e caktuar, pra në territorin e Gjykatës themelore në Tetovë. Poashtu, do te marr intervista(intervistoj) edhe nga qytetarët, lidhur me këtë problemakë mjaft komplekse.

Metoda historike

Nëpërmjet kësaj metode do të analizojmë periudha te ndryshme kohore gjatë historisë, si dhe paraqitjen dhe trajtimin e kësaj problematike në periudha të ndryshme.

KAPITULLI I PARË

VEPRA PENALE E DHUNIMIT-

1. Nocioni i veprës penale të dhunimit

Në botën bashkëkohore vërehet një shtim i madhë i të gjitha sjelljeve kriminale që manifestohen me aplikimin e agrisivitetit dhe dhunës ndaj individëve, familjeve, grupeve të caktuara etnike, nacionale etj.¹

Sipasa autorit Franjo Baçiç² kriminalitetin e dhunës, në çfarëdo forme e cilësojnë, disa veti; në rend të parë, ai gjithmonë nënkupton aplikimin e dhunës fizike dhe psikike dhe se viktimat me veprimet e dhunës përherë detyrohet të veprojë ose të mos veprojë. Me veprime kriminale të dhunës kërcenohet integriteti trupor dhe jeta ose liria e viktimës. Si dhunë konsiderohet edhe shtrëngimi dhe maltretimi psikik, shkaktimi i shqëtesimit dhe pasigurisë së përhershme psikike.

Veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor paraqesin ato veprime të kundërligjshme, të kryera me faj, të cilat çenojnë lirinë dhe moralin gjinor. Veprat penale të cilat trajtohen në këtë kapitull, objekt mbrojtës kanë lirinë e personit në marrëdhëniet seksuale dhe moralin gjinor të tij. Duke paraparë sanksionet penale për këto vepra penale dënohet: dhuna, keqpërdorimi i pozitës dhe shfrytëzimi i personit të paafët, mbrohet liria e vendosjes se kur dhe me kënd do të ketë marrëdhënie seksuale një person. Veçanërisht gjatë përcaktimit juridiko-penal të veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, mbrojtje e posaçme është paraparë për personat e mitur. Këto vepra penale mund të kryhen vetëm me dashje. Ç'është shoqëria bashkëkohore që pretendon mbrojtjen e individit, gjithashtu në plan të parë ka edhe mbrojtjen e moralit dhe dinjitetin e tyre.

¹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq. 173, veprë e cituar

² Po aty

Njëkohësisht shtetiku jdeset t'u ofrojë edhe mbrojtjen juridiko-penale nëpërmjet parashikimit të veprave penale që e cënojnë moralin dhe dinjitetin.³

Jeta e njeriut është e pacënueshme(n.10, i Kushtetutes se R.Maqedonisë). Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacënueshëm(n.11). Dinjiteti i njeriut është i pacënueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.(n.23, i Kushtetutes se R.Kosoves). Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj(n.26).

Liria seksuale dhe morali gjinor janë dy vlera njerëzore të cilat e përbëjnë objektin mbrojtës të këtyre veprave penale. Ato janë të lidhura mes veti dhe është e pamundur të bëhet një ndarje mes tyre, andaj edhe janë futur si objekt i përbashkët i këtyre veprave penale, të cilat trajtohen në kuadër të një kapitulli, si në legjislacionin penal vendor, poashtu edhe në vende të tjera. Prandaj si vepra penale të këtij grupi bëjnë pjesë ato aktivitete dhe veprime të cilat manifestohen me përdorimin e dhunës ndaj personave që detyrohen në marrëdhënie intime dhe seksuale. Në këtë vështrim, kodi penal fokusohet në disa forma të marrëdhënieve seksuale të cilat kryhen me mashtrim, mbajtje ose shtyrje në prostitucion dhe në fund me disa forma të akteve amorale⁴.(Incesti, kënaqja e epsheve seksuale para tjetërkujt etj).

Disa autorë konstatojnëse veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor bëjnë pjesë edhe në krime kundër njërezimit. Sipas tyre, dhunimi është vepra penale më tipike kundër integritetit seksual, e cila paraqet një nga format e manifestimit të dhunës ndaj njeriut. Marrëdhënia intime është manifestim i natyrshëm i ndjenjave mes njerëzve, shtytës i së cilës është instinkti seksual, andaj vetë akti seksual si i tillë, nuk është i kundërligjshëm, e me këtë as i ndëshkueshëm. Vetëm në rastet kur si mjet për realizimin e tij përdoret dhuna apo kanosja, akti në fjalë nga kornizat e lejuara kalon në sferën e cila është e mbrojtur me dispozita penale-juridike. Veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, e konkretisht dhunimi, bëjnë pjesë në grupin e veprave penale të përbëra jo të drejta, sepse te kjo vepër penale përdorimi i dhunës apo kanosja janë sjellje të cilat ndëshkohen, ndërsa vetë marrëdhënia seksuale, si e tillë nuk konsiderohet vepër penale.⁵

³ Ismail Zejneli, E drejta penale–Pjesa e posaçme-Cikël leksionesh, Tetovë, 2007, fq. 79.

⁴ Blerta Ahmedi, punim magjistrature, veper e cituar; Nikola Srzentić, Aleksandar Stajić, Krivično pravo, Opšti i posebni deo, Zavod za izdavanje udžbenika, Sarajevo, 1968, fq. 360.

⁵ Po aty; vepër e cituar

Trajtime historike lidhur me veprën penale të dhunimit

Dhuna seksuale është e pranishme në të gjitha shtetet dhe shoqëritë bashkëkohore, madje edhe në ato vende me zhvillim ekonomik dhe liberalizim demokratik.⁶ Sipas disa studimeve që janë zhvilluar në Kanada, Zelandë të Re, Britani e Madhe, SHBA, dhe në Koren e Jugore është konstatuar se 8-15% të grave janë të dhunuara në moshë të re.⁷ Nëse kësaj i shtohen edhe tentim dhunimet, numri rritet deri në 20-27%.

Pikëpamjet e para ose qasja mjaft e përhapur e sjelljeve mjaft agresive kriminale, është qasja sipas teorisë psikoanalitike dhe shpjegimeve të Frojdit. Sipas Frojdit shkaqet e dhunës dhe sjelljeve agresive duhet të kërkohen në sferën instiktive dhe të nënvetëdijes-subkoshencës së personalitetit.⁸ Erih Fromi, një pasues i mësimave psikoanalitike, lidhur me sjelljet e personalitetit të njeriut thekson, se te ai me vetë faktin e lindjes së tij ekzistojnë dy lloje të agresivitetit ose sjelljes violente, e para është; sjellja agresive defansive, ndërsa e dyta është sjellja agresive destruktive.

Në paraqitjen e kriminalitetit të dhunës thuhet se ndikojnë edhe disa çrregullime apo devijime gjenetike, sidomos çrregullimi i rradhitjes së strukturës së kromozomeve.⁹ Konstatohet se prania e kromozomeve të tepërta y, te disa individë kriminelë, nxit sjelljen e dhunës. Kjo strukturë ose pasqyrë e kromozomeve, sidomos te meshkujt-struktura xyy quhet strukturë e kromozomeve vrasëse. Te popullata normale jodelikuate, çrregullimi kromozomik sillet prej 0,5% deri në 2%, ndërsa te popullata delikuate, kjo pasqyrë sillet kah 2,8%. Megjithatë, këto studime dhe konstatime merren me rezervë ngase janë berë në raste të vogla apo në numër të vogël të personave që kanë qenë objekt eksperimentimi dhe kjo don të thotë se eksperimentet e tilla janë automatikisht të sigurta.

⁶ Komentari i Kodit Penal të Kosovës, Prishtinë, 2014, fq.605

⁷ Po aty, vep. e cituar

⁸ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.175, vepër e cituar

⁹ Po aty

Sipas autorit Siegel, sjellja njerëzore e cila mund të jetë kriminale (e papranueshme), apo konform (e pranueshme) varet nga mundësitë e tij që të mësojë dhe të arrij qëllimet të cilat janë rezultat i veprimit të dy grupeve të mëdha faktorësh. Grupi i parë i faktorëve përfshinë vetitë personale të njeriut, e të cilat çdo person e bëjnë unikat e që kanë të bëjnë me strukturën biokimike, kodin gjenetik dhe gjendjen neurologjike dhe i cili krijon presionin e brendshëm që kërkon veprime të caktuara njerëzore. Në anën tjetër në sjelljen e njeriut në veprimin e vetive personale dukshëm ndikon edhe grupi i faktorëve të rrethit social ndër të cilët rolin themelues e luan ndikimi i prindit, grupet e vogla shoqërore, shkolla dhe rrethi¹⁰. Të dhënat statistikore vejnë në dukje edhe faktin që në praktikë ekziston një numër i madh vendbanimesh që nuk kanë karakter të hapësirës së mbrojtur, e megjithatë shkalla e kriminalitetit në ato zona është shumë më e vogël në krahasim me disa zona të qytetit që kanë karakteristika të shprehura të hapësirës së mbrojtur¹¹.

Teoria e kontrollit është një nga teoritë më të rëndësishme të veprimeve kriminale, e megjithatë dy versionet e saj më të njohura dallohen. Arsytimi më i njohur mbi teorinë e kontrollit është dhënë në librin “Shkaqet e delikuencës” të Travis Hirschit, 1969. Hirschi thekson se kriminalitetit nuk i nevojitet ndonjë motivim i veçantë: nuk është problem të sqarohet pse njerëzit bëjnë vepra kriminale, por pse nuk i bëjnë. Përgjigjja në pyetjen e dytë qëndron në kontrollin shoqëror, ashtu që shoqëria më e madhe e shtyn individin të heq dorë nga qëllimet e veta dhe t’u përmbahen rregullave. Shumë teoricienë të kriminalitetit theksojnë rregullat dhe sa i mësojnë ose nuk i mësojnë njerëzit mirë. Hirschi haptas i shmanget kësaj teorie duke thënë në mënyrë të qartë se secili i di rregullat dhe i ka bërë pjesë të sjelljes së vet, e megjithatë i cenon duke shkuar pas dobësive themelore njerëzore. Lidhjet shoqërore ndihmojnë që të mposhten ato dobësi dhe të sillen në pajtim me konventat shoqërore, e atyre që u mungojnë kontrollet e tilla synojnë kryerjen e veprave kriminale dhe delikuede. Dy decaie pasi që ishte paraqitur kjo vepër, Michael Gottfredson dhe Travis Hirschi më 1990 kishin botuar “Teorinë e përgjithshme mbi kriminalitetin”. Kjo vepër theksonte konceptin që kriminalitetit nuk i nevojitet ndonjë

¹⁰ Z.Surdulli, punim doktrature, Tetove, 2018., vepër e cituar; J.L. Siegel, “Criminology Thomson Learning”, Belmont (USA), 2006.

¹¹ Po aty, vepër e cituar; Nedžad Korajlić, Metodika Krimianalistike (deliktet e gjakut, seksuale, pasurore), Sarajevë/Prishtinë 2007, FSK/S-15/06.

motivacion i veçantë. Ajo shkon mjaft më larg nga vetë kriminaliteti, duke sqaruar kontrollet shoqërore që u ndihmojnë njerëzve; p.sh. që të kryejë punën mirë, të mësojnë mirë në shkollë, të ngasin në mënyrë të sigurt automjetin, të funksionojnë si prindër të mirë dhe të shpenzojnë me maturi.¹²

2. Aspekte krahasimore të veprës penale të dhunimit

3.1.Aspekte krahasimore me R.Kosovës

Vepra penale e dhunimit kryhet në rastet kur ndokush e detyron personin tjetër të kryejë akt seksual pa pëlqimin e atij personi.¹³Kjo formë e parë e veprës penale kryhet në situatat kur nuk përdoret dhunë apo kanosje por kryhet pa pëlqimin e viktimës, pra kundër vullnetit të viktimës.

Sipas paragrafit 1, të n.192, shprehja “pëlqim” nënkupton pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjet për të kryer aktin seksual. Nuk ekziston pëlqimi nëse:

- personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë;

- pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës;

- pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin siç është paraparë në nenin 230 paragrafi 3. të këtij KPPK-së; ose

- personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera.

¹²Po aty; Elmendin Muratbegovic, Parandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevantion and Crime Control), Sarajevë/Prishtinë, prill 2017, Faqe 61.

¹³ Ismet Salii, E drejta penale e posaçme, Prishtinë,2009,fq.207

Në mungesë të pajtimit, me mashtrim ose duke e shfrytëzuar gjendjen e dehur me alkool, me drogë apo substancë tjetër joshëse, gjendje kjo e krijuar jo nga kryerësi i veprës por nga vetë viktima apo nga ndonjë person i tretë, kështuqë kryerësi i kësaj vepre penale e shfrytëzon gjendjen e viktimës, gjendjen kur viktima nuk është e aftë të rezistojë, por me fjalë apo me sjellje nuk dakordohet, nuk jep pëlqimin që të ketë mardhënie seksuale.

Ne Paragrafin 4.-te Kodit penal te Kosoves- Kur vepra penale nga paragrafi 1.ose 2. i këtij neni **kryhet në një ose më shumë** nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet:

- veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor, me perdorim te forces,

- kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit

- kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;

- kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;

- vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;

- kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, çrregullimit apo paaftësisë fizike apo mendore, ose shtatzënisë;

- kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezja apo halla, vëllai ose motra e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;

- kryesi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;

- kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit.

- Kur vepra nga ky nen rezulton me vdekjen e viktimës, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.¹⁴

2.2.Aspekte krahasimore me R.Shqiperisë

“Marrëdhënia seksuale kuptohet bashkimi seksual normal midis një mashkulli dhe një femre”.¹⁵ Dhuna seksuale në Kodin penale të R.Shqipërisë është e rregulluar në nenet 100-108.

Ushtimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërmëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.¹⁶ Në n.108/a, është sanksionuar edhe ngacmimi seksual. Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që çënojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Lidhja fiziologjike normale që ndodh vetëm midis personash të sekseve të ndryshme, midis burrit dhe gruas, gjithë veprimet e tjera të drejtuara në përmbushjen e dëshirës seksuale në forma të tjera nuk janë bashkime seksuale.¹⁷

¹⁴ Kodi Nr. 04/L-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2013.

¹⁵ Ismet Elezi, E drejta penale-pjesa e posaçme , Tiranë, 2007, faqe 106

¹⁶ Kodi penal i R.Shqipërisë,n.107-a, Tirane,2016

¹⁷ Bardhyl Cipi dhe Sokrat Meksi, Mjeksia Ligjore, Tiranë, 2005, faqe 145

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, me dhunë, me fëmijë të mitur në moshën katërbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.(n.101, par.1,i KPShqiperise).

Në vijim përmes tabelës do të prezantojmë figurat e veprave penale që bien në kapitullin e veprave penale kundër integritetit seksual ne legjislacionet e; Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë.¹⁸

MAQEDONIA	SHQIPËRIA	KOSOVA
Dhunimi dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur Denohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Për pasojë vdekjen: jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm	Dhunimi Dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet. Per vdekje te viktimës eshte parapare denim me burgim prej dhjete viteve deri ne denim me burgim /burgim të përjetshëm.
Kryerja e aktit seksual me person të paaftë (të pafuqishëm) Kryeresi per kryerjen e kesaj vepre dënohet me së paku tetë vjetë burgim.	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç Kryerësi për kryerjen e kësaj vepre dënohet pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Për vdekjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.	Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit Kryeresi per kryerjen e kesaj vepre dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet. Nese shkaktohet vdekja, eshte parapare denimi me burgim te perjetshem.
Sulmi seksual ndaj të miturit që nuk ka ambush 14 vjet Kryeresi per kryerjen e kesaj vepre dënohet me së paku tetë vjet burgim. Nese shkaktohet	Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura Vepra e kryer në mes të bashkëshortëve,apo bashkëjetuesve, prej tre deri në	Sulmi seksual Kryeresi per kryerjen e kesaj vepre dënohet me gjobë ose me burgim deri

¹⁸ Z.Surdulli, punim doktrature, Tetove,2018.

lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasoja tjera të rënda ose vepra është kryer nga më shumë persona apo në mënyrë posaçërisht të vrazhdë dhe nënçmuese, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim të përjetshëm.	dhjetë vjet. Me pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.	në një vjet.
Kryerja e aktit seksual me keqpërdorim të pozitës Kryerësi për kryerjen e kësaj vepre dënohet me së paku pesë vjet burgim.	Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur Kryerja e marrëdhënieve homoseksuale dënohet prej tre deri në shtatë vjet pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.	Degradimi i integritetit seksual Kryerësi për kryerjen e kësaj vepre dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në një vit.
Kënaqja e epsheve seksuale para tjetërkujt Kryerësi për kryerjen e kësaj vepre dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur Kryerësi për kryerjen e kësaj vepre dënohet me burgim prej pesë gjer në dhjetë vjet. Nëse vepra e ka për pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e personit të dëmtuar dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.	Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale Kryerësi për kryerjen e kësaj vepre dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet

Ndërmjësime në ushtrimin e prostitucionit Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet.	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.	Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me burgim prej pesë deri në njëzet vjet.
Shtirja dhe të mundësuarit e veprimeve seksuale Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me së paku tetë vjet burgim.	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me burgim prej gjer në tre vjet.	Nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me burgim prej (2) deri në dhjetë (10) vjet.
Ekspozimi i materialit pornografik të miturit Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me denim me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me burgim prej gjer në shtatë vjet.	Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.
Prodhimi dhe distribuimi i pornografisë fëmijërore Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me së paku pesë vjet burgim.	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Nëse vepra ka pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se	Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi Kryerësi për kryerjen e kësaj veprë dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

	njëzet e pesë vjet.	
Tërheqja në prostitucion apo në veprim tjetër seksual personin e mitur I cili nuk ka mbushur 14 vjet Kryerësi për kryerjen e kësaj vepre dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.	Neni 107/a Dhuna seksuale Ushtrimi i dhunës seksuale, Kjo veper kryhet nëpërmjet veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Nëse vepra ka si pasojë edhe vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.	Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin Kryerësi për kryerjen e kësaj vepre dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Nga tabela e mësipërme vërejmë disa dallime, duke filluar nga numri i figurave penale, mbi të cilat sanksionohen veprat penale kundër integritetit seksual. Në këtë pikë prinë Kosova me katërbëdhjetë, më pas vie Maqedonia me njëmbëdhjetë figura veprash penale dhe Shqipëria me nëntë figura të veprave penale.

Edhe sa i përket minimumit dhe maksimumit të veprës penale të dhunimit ka dallim në mes të legjislacioneve të lartëpërmendura.

Kur flitet për praninë e krimeve seksuale e veçmas të dhunimeve seksuale ndaj femrave të rritura, sipas të dhënave statistikore të policisë së SHBA-ve, del se në 100.000 banorë të gjinisë femërore, 70 persona të kësaj gjinie në vit janë viktimë e dhunës seksuale.¹⁹ Stopa e kryerësve të dënuar të krimeve të dhunimeve seksuale në disa shtete në 100.000 banorë duket si vijon; në Zvicër 27,9 të dënuar, në Gjermani 13,6 të dënuar, në Austri 33,8%.

Krimet seksuale fatkeqësisht paraqiten edhe në Kosovë dhe në Shqipëri, por edhe në vise të tjera të regjionit. Mirëpo, lidhur me këto krime nuk janë bërë kërkime dhe studime në bazë të cilave do të nxireshin konkludime valide²⁰. Si kryerës por edhe si viktima të këtyre krimeve po paraqiten persona të moshës së re të cilët për motive të llojllojshme janë kyçur në këto veprime

¹⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.191

²⁰ Po aty, vepër e cituar

kriminale të rrezikshme. Kryerësit e delikteve seksuale si në Kosovë dhe gjithëkund gati në 55% të rasteve janë persona të cilët edhe më parë kanë kryer veprime të tilla.

3. Përgjegjësia juridiko-penale e kryerësve të veprave penale të dhunimit

I aftë për faj është kryerësi që është ***i përgjegjshëm*** gjatë kohës së kryerjes së veprës penale. Përgjegjshmëria është një ndër elementet themelore të fajit (shih n.11 p.1 KPM), ndërsa sipas (n.12 p.1), nuk është i përgjegjshëm kryerësi që gjatë kohës së kryerjes së veprës penale nuk ka mundur ta kuptojë rëndësinë e veprës së tij ose nuk ka mundur të udhëheqë me veprimet e tij për shkak të sëmundjes së përhershme ose të përkohshme psikike ose për shkak të pengesave tjera të rënda psikike.

Pasi që përgjegjësia penale është kusht për zbatimin e dënimeve sipas kryesit të veprës, ajo duhet të ekzistoi dhe në kohën e kryerjes të veprës penale. Kjo d.m.th që aftësia mendore dhe fajësia duhet të ekzistojnë në momentin e kryerjes të veprës penale në raport me veprën penale konkrete të kryer.²¹ Aftësia mendore dhe fajësia mund të maten sipas shkallës, d.m.th mund të ekzistojnë shkallë më e lart ose më e ultë e aftësisë mendore si dhe shkallë më e lartë ose më e ultë e fajësisë në varësi nga shkalla dhe intensiteti i paraqitjes së elementeve subjektive dhe psikike (vetëdijes dhe dëshirës) të kryesit të rastit konkret. Kjo d.m.th që përgjegjësia penale mund të matet me shkallë. Ky fakt është shumë i rëndësishëm, sepse nga shkalla e përgjegjësisë penale, varet jo vetëm lloji dhe lartësia e dënimit për veprën e kryer, por në disa raste dhe ekzistimi i dënimit e me këtë edhe ekzistimi i veprës penale.

Baza biologjike e papërgjegjshmërisë²², janë; sëmundja e përhershme psikike, sëmundja e përkohshme, çrregullim i përkohshëm psikik, zhvillimi i prapambetur psikik, pengesa tjera të rënda psikike. Disa legjislacione më të vjetra (Franceze) por edhe më të reja (Kroate), me precizitet i përmbahen parimit “nullum crimen, sine culpa” dhe përcaktimit - e drejta penale të merret vetëm me *kryerësit e përgjegjshëm dhe fajtorë*. Ai që në gjendje të papërgjegjshme do të

²¹ B.Petroviç, E drejta penale, Sarajevë, 2006, fq.66

²² V.Kambovski, veprë e cituar, më gjërësisht, shih, Novotni, 35; Hajdukovic, 104; Mezger, 6; Jorda, 64

kryejë ndonjë vepër që me ligj është e paraparë si vepër penale, nuk trajtohet si “*kryerës i veprës penale*”, por me të si edhe me personat e sëmurë psikikisht veprohet sipas parimeve të *të drejtës medicinale*. Në të drejtën penale, imponohet nga nevoja për të siguruar garanci penalo-juridik për liritë dhe të drejtat e tyre, por edhe nga zbatimi i masave penalo-juridik për t’iu përgjigjur *gjendjes së rrezikshme* të personit të shkaktuar nga rrethanat biologjike të papërgjegjshëm. Prandaj, KPM parasheh shqiptim të *masave të sigurisë*: mjekim i domosdoshëm psikiatrik dhe ruajtje në entin shëndetësor dhe mjekim i domosdoshëm psikiatrik në liri si sanksione të vetme të kryerësve të papërgjegjshëm (n.63 dhe 64). Masë të këtillë, gjykata mund të shqiptojë kur do të konstatojë se për shkak të papërgjegjshësisë, kryerësi mundet *përsëri të kryejë vepër penale*, kurse *për evitim të rrezikut të tillë* nevojitet mjekim i tij dhe ruajtje në ent shëndetësor apo mjekim në liri.²³

Përgjegjia penale përbëhet prej dy elementeve;²⁴ **a)**-nga vetitë e caktuara psikike të kryerësit (përgjegjësia) dhe **b)**-nga mardhënia e kryerësit ndaj veprës që e ka kryer (fajësia).Përgjegjësia dhe fajësia janë të lidhura ngusht në mes veti, së këndejmi nëse një person nuk është i përgjegjshëm, nuk është i aftë të kuptojë rëndësinë e veprës dhe ti kontrollojë sjelljet e veta, atëherë nuk mund të konsiderohet i fajshëm. Kjo nga fakti se përgjegjësia, është baza në të cilën mbështetet fajësia.Ndërsa, në anën tjetër një person mund të jetë i përgjegjshëm, por të mos jetë i fajshëm për veprën e kryer.

Lidhur me fajsinë, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm se me përdorimin e forcës dhe kërcënimit është duke e kryer aktin seksual.(n.186,i KPM-së).

Në të drejtën penale, një person konsiderohet i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka poseduar cilësi të caktuara psikike dhe nëse tek ai ka ekzistuar një mardhënie e caktuar psikike ndaj veprës që ka kryer.²⁵ Pra, një person do të konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.

²³ Po aty.

²⁴ Ismet Saliu, E drejta penale e përgjithshme, Prishtinë, 2010, fq.274

²⁵ Komentari i Kodit Penal të Kosovës, Prishtinë, 2014, fq.72

Përgjegjësia penale, në kuadrin e saj përgjegjësia dhe fajsia, mund të shkallëzohet, mund të manifestohet me intensitet të ndryshme.²⁶ Rrjedhimisht, me rastin e kryerjes së veprës penale mund të shprehet një shkallë më e vogël apo më e madhe e përgjegjësisë dhe fajsisë. Kështu psh, kryerësi mund të kryejë vepër penale në gjendje të përgjegjësisë së plotë apo përgjegjësisë së zvogluar, prej ku varet edhe lartësia e dënimit.

²⁶ Po aty

KAPITULLI I DYTË

1. Format e veprës penale të dhunimit

Vepra penale e dhunimit në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë është paraparë në kapitullin e XIX-të, të emëruar si: “Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor”. Në kuadër të këtij kapitulli bëjnë pjesë edhe vepra të tjera cënimit moral si; vepra penale e dhunimit me persona nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet; keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin; nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës; marrëdhëniet seksuale brenda familjes etj.

1.1. Vepra penale e dhunimit

Ai i cili me përdorimin e forcës apo kërcënimit do të detyrojë personin tjetër të kryejë akt seksual pa pëlqimin e tij, do të konsiderohet se ka kryer vepër penale të dhunimit.²⁷ Këtë vepër penale e kryen ai që me forcë ose me kërcënim e sulmon jetën ose trupin e tjetrit, ndërsa tjetri detyrohet në aktin seksual. Detyrimi në aktin seksual ose veprimi tjetër gjinor kryhet me përdorimin e forcës dhe të kërcënimit.

Dhunimi domethënë mosekzistimi i dëshirës dhe vullnetit të njërit person për aktin seksual. Kundërshtimin të cilin e jep personi i dhunuar duhet të jetë serioz dhe i vazhdueshëm, pasi që nuk do të konsiderohet se ekziston dhunimi nëse personi me të gjithë fuqinë nuk e kundërshton sulmuesin.²⁸ Subjekt pasiv është çdo person i gjinisë femërore ose mashkullore, që me dhunë detyrohet në aktin seksual. Subjekt pasiv mund të jetë edhe personi me të cilin jeton kryerësi, i martuar, ose në lidhje jashtëmartesore.

Gjatë trajtimit dhe hulumtimit të kësaj teme të magjistraturës-Vepra penale e Dhunimit-ne Gjykatën themelore në Tetovë, gjatë periudhës 2012-2017, kemi vërejtur se, gjatë periudhës


²⁷ Ismet Salii, E drejta penale e përgjithshme, Prishtinë, 2010, fq. 280

²⁸ Po aty

në fjalë janë kryer gjithsej, 17 vepra penale të dhunimit, prej të cilave; në 12 raste gjykata ka shqyptuar aktgjykim dënues, ndërsa në 5 raste është ndërprerë procedura penale. Sipas viteve; në vitin 2011- 2 raste; në vitin 2012-7 raste, në vitin 2013-4,raste; në vitin 2014, 1 rast; në vitin 2015-asnjë rast, në vitin 2016-1, rast dhe në vitin 2017-1, rast.

Në vijim të dhenat statistikore të lartëprezentuara do ti paraqesim nëpërmjet tabelës dhe grafikonit.

Vepra penale	Viti	Lloji i vendimit gjyqësor
Dhunimi	2011	Aktgjykim dënues
-//-	2011	Aktgjykim dënues
-//-	2012	Aktgjykim dënues
-//-	2012	Aktgjykim dënues
-//-	2012	Aktgjykim dënues
-//-	2012	Aktgjykim dënues
-//-	2012	Aktgjykim dënues
-//-	2012	Dënim me burg
-//-	2012	Aktgjykim lirues
-//-	2013	I liruar nga ndjekja
-//-	2013	I liruar nga ndjekja
-//-	2013	Dënim me burg
-//-	2013	Dënim me burg
-//-	2014	Denim me burg
-//-	2015	///////
-//-	2016	Dënim me burg
-//-	2017	Dënim me burg



1.2. Vepra penale e dhunimit me persona që nuk kanë mbushur 14,vjet

Personi që nuk e ka mbushur moshën 14-vjet, konsiderohet çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është e përcaktuar si vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me të holla apo dënim me burg mbi tre vjet, apo veprim që me ligj është përcaktuar si vepër kundërvajtëse nëse i ka mbushur shtatë, por nuk i ka mbushur 14 vjet.²⁹ **Fëmijë në rrezik** konsiderohet çdo fëmijë i cili i ka mbushur **shtatë vjet** por nuk i ka mbushur 18 vjet, i cili ka paafësi fizike apo mentale, një viktimë e dhunës në familje, jo i edukuar dhe socialisht jo i favorizuar, i cili është në atë gjendje sa që është e vështërë ose e pamundur realizimi i funksionit edukues të prindërve, kujdestarëve, që nuk janë të përfshirë në sistemin edukues, që janë të dhënë pas lëmshës apo prostitucionit, i cili përdor droga dhe substanca tjera psikotropike apo alkool, dhe për shkak të këtyre kushteve mund të vije në kontakt me ligjin si viktimë ose si dëshmitarë i një veprimi që me ligj është e paraparë si kundërvajtje ose si vepër penale.

²⁹ Ligjit mbi të drejtat e fëmijëve i R.Maqedonise,(Gazeta zyrtare nr.143, viti 2013)

Masat për ndihmë dhe mbrojtje rregullohen me nenet 13-17 të LDM-së Ato mund të shqiptohen ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet – fëmijës në rrezik si dhe ndaj të miturit të ri në rrezik apo të miturit të moshuar në rrezi kur Qendra për punë sociale vlerëson se gjendja për rrezik shprehet në zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe edukimin e drejtë të tij dhe mund të ndikojë te individi që të kryejë veprë penale ose kundërvajtje. Masat për ndihmë dhe mbrojtje mund të aplikohen edhe ndaj anëtarve të familjes kur ata i lënë anësh ose keqpërdorin kryerjen e të drejtave dhe obligimeve përsa i përket mbrojtjes së personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës.

Ai i cili do të kryejë aktin seksual apo veprim tjetër seksual ndaj femijes i cili nuk ka mbushur 14 vjet, do të dënohet me së paku dymbëdhjetë vjet burgim (n.188,i, par.1, KPM-së)

Nëse shkaktohet lëndim i rënde trupor, vdekje apo pasojë tjetër e rënde ose vepra është kryer nga më shumë persona apo veçanërisht në mënyrë të vrazhdët ose nënçmuese, kryerësi do të dënohet me më së paku pesëmbëdhjetë vjet burgim apo me burgim të përjetshëm. Ndaj kryerësit të veprës nga par.2, gjykata do t'i shqiptojë ndalesë për të kryer profesion, veprimtarinë apo detyrën nën kushtet nga n.38-b, nga ky kod. (n.188,i,par.2,dhe 3, KPM-së).

Qëllimi i inkriminimit është parandalimi i mardhënieve seksuale apo formave tjera të epsheve seksuale me persona nën moshën 14 vjeçare, nga shkakut se personat e këtille, për këso mardhënie nuk e kanë arritur moshën e pjekurisë së duhur psikike dhe fizike dhe se mardhëniet seksuale në këtë moshë ndikojnë dëmshëm në shëndetin dhe zhvillimin e tyre.³⁰

Subjekt pasiv, viktimë e kësaj veprë penale është personi i gjinisë femërore apo mashkullore nën moshën 14 vjeçare, ndërsa kryerës është personi madhor, qoftë i gjinisë mashkullore apo femërore.³¹

Për nga fajësia kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje e cila përfshin edhe vetëdijen se kryen mardhënie seksuale me personin nën moshën 14 vjet.


³⁰ I.Saliu, E drejta penale-pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009, fq.221

³¹ Po aty

Kjo veprë në shkencën e mjekësisë dhe në opinion njihet me emërtimin pedofili. Pedofilia është fjale greke e cila ka kuptimin e një lloji patologjie të epsheve seksuale e cila manifestohet me predispozita të epsheve seksuale të personave madhore ndaj fëmijëve.

Në vijim do të paraqesim të dhëna statistikore nga ana e Ministrisë së punëve të mbredshme lidhur me kryerësit e veprave penale sulm seksual ndaj fëmijëve për periudhën, 2010-2016

Gjendja e delikteve seksuale							
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sulm seksual ndaj fëmijëve	61	35	34	47	43	38	30
Kryerës	71	37	35	51	54	38	28



1.3.Vepra penale e dhunimit me persona me çrregullime ose paaftësi mendore

Çrregullii psikik definohet si gjendje e prishjes së funksioneve psikike, e shkaktuar nga arsytet *endogjene apo ekzogjene*: temperatura, alkoolizmi, narkomania, hipnoza, somnambulizmi etj. Nuk konsiderohet si sëmundje e përkohshme psikike papjekuria e duhur emocionale dhe sociale.³² Është prapambeturi intelektuale dhe e karakterit për shkak të *mos zhvillimit të sistemit nervor*, i shkaktuar nga anomali të lindura (oligofrenia, kretenizmi) ose të fituara (demencë, sklerozë) ose nga mos jetesa në mjedis social.

Për dallim nga dhunimi ku kryerësi e then kundërvënien e viktimës, këtu ai e shfrytëzon mosdijen apo pafuqinë e viktimës për tu kundërvënë, mungesën e vullnetit si dhe dëshirën për të vendosur vetë lidhur me mardhëniet seksuale.³³ Viktimë e veprës penale është personi që nuk është i aftë për t'u kundërvënë për arsye se është i sëmurë shpirtërisht, ai është person i cili nuk e kupton domethënien e aktit seksual.

Element kryesor është keqpërdorimi i mungesës së personit për t'u kundërvënë. Keqpërdorimi i mungesës për tu kundërvënë paraqet motivacionin special të kryerësit për ta shfrytëzuar gjendjen e paaftë për ta keqpërdorur viktimën përkatësisht gjendjen në të cilën gjendet ajo.³⁴

Ai i cili ndaj tjetrit do të kryejë akt seksual, duke keqpërdorur sëmundjen shpirtërore, çrregullimin shpirtëror, pafuqinë zhvillimit e ngecur shpirtëror apo ndonjë gjendje tjetër për të cilën ai person është i paaftë për rezistencë, do të dënohet me më së paku tetë vjet burg (n.187,par.1,KPM-së).

Nëse për shkak të veprës nga par.1, shkaktohet lëndim i rënde trupor, vdekje apo pasojë tjetër e rëndë ose vepra është kryer nga më shumë persona, në menyrë posaçërisht të vrazhdët apo nënçmuese, kryerësi do të dënohet me më së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. (n.187,par.3,KPM-së).

³² V.Kambovski, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Shkup,2006,fq.

³³ I. Zejneli, E drejta penale-pjesa e posaçme, Tetovë,2007, fq.81

³⁴ Po aty

Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore apo me paaftësi mendore paraqet inkrimin të posaçëm me të cilin shtrihet mbrojtja penalo-juridike e integritetit seksual të persoanve me të meta psikofizike të cilët në rastin konkret nuk janë në gjendje të kundërshtojnë veprimet të cilat çënojnë integritetin e tij seksual.³⁵Qëllimi i inkriminimit të kësaj vepre rrjedh nga qëndrimi i gjithë pranuar, se shfrytëzimi seksual i personave të paaftë për ti kënaq epshtet e veta seksuale çënojnë rëndë normat morale dhe sociale dhe etike të sëcilës shoqëri.

Kryrës i kësaj vepre penale mund të jetë mashkulli ose femra, poashtu edhe subjekti pasiv(viktima), mund të jetë i gjinisë mashkullore ose femërore.³⁶Për të ekzistuar kjo vepër penale, viktimë dihet të jetë person me çrregullime mendore apo emocionale, persona me sëmundje psikike të cilët jo vetëm që nuk kanë aftësi për të kundërshtuar, por nuk janë as në gjendje psikike për ti kuptuar veprimet e veta dhe pasojat e saj.

Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin

Kjo vepër është paraparë me qëllim që të mbrohet integriteti seksual i personave të cilët gjenden në pozitë të varur apo të nënshtruar ndaj tjetrit.³⁷Mënyra me të cilën ia del të kryejë aktin seksual me viktimën duke e keqpërdor pozitën, autoritetin apo profesionin, mund të manifestohet me veprime të ndryshme, psh;duke i propozuar të ketë mardhënie seksuale, duke e nxitur, duke kërkuar, duke ia bërë me dije në ndonjë mënyrë se dëshiron të kryejë akt seksual.

Pozita nënshtruese apo e varësisë më së shpeshti shprehet në aspektin ekonomik, material.³⁸Kështu, kjo vepër penale kryhet duke i ofruar viktimës favore ekonomike apo avancim në detyrë ose duke ia bërë me dije se do të ketë pasoja të dëmshme nëse nuk pranon të ketë mardhënie seksuale. Kjo vepër konsiderohet se kryhet edhe në rastin kur kryerësi drejtpërdrejt

³⁵ Komentari i Kodit Penal të Kosovës, Prishtinë, 2014, fq.630

³⁶ Po aty

³⁷ I.Salihu, E drejta penale-pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009,fq.225

Për të ekzistuar kjo vepër penale nuk duhet të ushtrohet dhuna apo kanosja, ngaese nëse ushtrohet dhuna apo kanosja atëhere do të konsiderohet se është kryer vepër penale e dhunimit. Gjithashtu, për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet të konstatohet se iniciativa për kryerjen e aktit seksual duhet të vijë nga personi që ka ndonjë pozitë, autoritet apo profesion, situata kto të cilat viktimën në rastin konkret e vënë në pozitë të varësisë..

³⁸ Po aty.

fillon të kryejë aktin seksual, ndërsa viktimja pranon të kryejë aktin seksual për shkak të frikës nga pasojat e dëmshme që do ta godasin, psh; frikësohet se nëse nuk do të pranonte të ketë marrëdhënie seksuale do t'i ndërpritej kontrata e punës.

Këtë veprë penale e kryen ai i cili do ta keqpërdor pozitën duke e shtyjë në aktin seksual, personin tjetër i cili ndaj tij është në pozitë të vartësisë ose varësisë. Ose duke e frikësuar, keqtrajtuar apo në mënyrë tjetër e përbuzë denjësitin dhe personalitetin njerëzor (189 i KPM-së).

Formë e rëndë e kësaj veprë penale është paraparë në paragraf 2, në rastet kur kjo veprë kryhet nga të afërmit e gjakut me fëmijët që i kanë mbushur 14 vjet, të cilët i është besuar për shkak të mësimit, edukimit, etj.

Ndaj kryerësit të veprës nga paragrafi 2, gjykata do ti shqiptojë ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës nën kushte nga n.38-b (paragrafi 3).

Gjykata mundet që kryerësit që i ka shqiptuar dënimin me burgim ose dënimin me kusht me të cilin është përcaktuar dënimi me burgim, ti ndalojë kryerje të profesionit, veprimtarisë së caktuar (n.38-b, paragrafi 1-KPM-së).

2. Ndërmjetësimi në kryerje të prostitucionit

Prostitucioni paraqet një sjellje devijante, negative shoqërore e cila çrregullon funksionimin normal të raporteve në mes gjinive në shoqëri dhe si e tillë është e dëmshme dhe e paparanueshme. Vetë prostitucioni ka të bëjë me dukurinë e marrëdhënieve seksuale të një personi të gjinisë femërore me një numër të pacaktuar të gjinisë tjetër me qëllim të fitimit³⁹ Prostitucioni shpesh është i lidhur me kryerjen e aktiviteteve kriminale, si p.sh.: vrasja për motive seksuale, dhunimet, lëndimet, etj.

Duke filluar që nga kohërat më të vjetra, dhe deri më sot prostitucioni, ka marrë trajtimin e llojllojshëm në shoqëri të caktuara. Shumë herë në histori prostitucioni është ndjekur edhe me

³⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, faqe 288;

ligj, kështu 600-vjet para erës sonë, ligjdhënësi grek Soloni ka tentuar ta rregullojë çështjen e prostitucionit⁴⁰

Prostitucioni paraqet një sjellje devijante, negative shoqërore e cila çrregullon funksionimin normal të raporteve në mes gjinive në shoqëri dhe si e tillë është e dëmshme dhe e paparanueshme. Vetë prostitucioni ka të bëjë me dukurinë e marrëdhënieve seksuale të një personi të gjinisë femërore me një numër të pacaktuar të gjinisë tjetër me qëllim të fitimit⁴¹

Gjatë dhjetë viteve të fundit dukuria e prostitucionit në Republikën e Maqedonisë ka fituar përmasa të gjera, duke u përhapur në të gjithë vendin. Aktivitetet e policisë në luftën kundër dukurisë së prostitucionit janë fokusuar në zbulimin dhe arrestimin e organizatorëve dhe ndërmjetësuesve të prostitucionit. Përkundër vështirësive të mëdha me të cilat ballafaqohet MPB-ja pjesëtarët e saj në disa raste kanë realizuar aksione të suksesshme, duke arrestuar personat që kanë organizuar dhe ndërmjetësuar këtë veprimtari.⁴²

Ai i cili shtinë, nxitë persona ne prostitucion ose ai i cili ne cfaredo menyre merr pjese ne dorëzimin e ndonje personi tjeterkujt per te kryer prostitucion, do te denohet me burgim prej pese deri në dhjetë vjet (n.191, par.1,KPM-së).

Ai i cili për shkak të fitimit i mundëson tjetërkujt shfrytëzimin e shërbimeve seksuale, do të dënohet me burgim prej tre deri në pesë vjet. (n.191, par.3, KPM-së).

Prostitucioni ka edhe përmasa ndërkombëtare.⁴³ Me konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare janë paraparë masa për luftimin e kësaj dukurie. Si psh, Mrëveshtja ndërkombëtare për mbrojtjen efikase nga tregtia kriminale e njohur si “Tregtia me robër të bardhë (1910), Konventa ndërkombëtare për luftimin e tregtisë me gra e fëmijë (1912), Konventa për luftimin e tregtisë me gra madhore (1933), dhe Konventa për luftimin dhe ndalimin e trafikimit me njerëz dhe shrytëzimin e prostitucionit (1950).

⁴⁰ I. Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq.171

⁴¹ Po aty vep.e cituar

⁴² Po aty

⁴³ Komentari i Kodit Penal të Kosovës, Prishtinë, 2014, fq.656

3. Vepra penale ekspozimi i materialit pornografik të miturit

Konventa për të *drejtat e fëmijës* i definon si fëmijë të gjithë qeniet njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, me përjashtim të rasteve kur ligjet nacionale njohin një moshë më të hershme madhore.

“I mitur” – konsiderohet çdo person deri në moshën 18 vjeçare i cili sipas Konventës për të Drejtat e fëmijës konsiderohen **fëmijë**.

Kjo vepër penale konsiderohet se kryhet nëse ndokush shet, ofron ose i jep fëmijut material audiovizual, fotografi, apo sende tjera me përmbajtje pornografike.⁴⁴ Veprën penale e kryen personi që fëmijut i bën fotografi pornografike dhe po ato fotografi i shet ose i ekspozon në publik. Veprimi i kryerjes është shitja ose të treguarit e këtyre fotografive.

Subjekt pasiv është fëmiju që me dije ose pa dije është i përfshirë në fotografi ose shfaqje pornografike.

Për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet. Nëse vepra është kryer nëpërmjet mjeteve të informimit publik, kryeresi do të dënohet me burgim prej tre deri në pesë vjet (n.193, par. e i KPM-së).

Forma më e rënde e kësaj vepre penale është paraparë në parag.6 të këtij neni dhe kryerësi do të dënohet me më së paku dhjetë vjet burgim, nëse vepra është kryer ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet.

Sendet e ekspozuara në publik, audio-vizuale ose sendet tjera me përmbajtje pornografike do të merren (parag.8).

Mjeti me të cilin kryhet kjo vepër penale është materiali me përmbajtje pornografike dhe shfaqjet e skenave seksuale.⁴⁵ Si materiale me përmbajtje pornografike konsiderohen; çdo shkresë, fotografi, audio incizim vizual apo tonik, ose çdo material tjetër me përmbajtje që i përket sjelljeve dhe akteve seksuale që mund të nxisin epshet seksuale. Veprimet me të cilat

⁴⁴ I.Zejneli, E drejta penale-pjesa e posaçme (cikël leksionesh), Tetovë, 2007, fq.85

⁴⁵ Komentar i Kodit penal të Kosovës, Prishtinë, 2014, fq.644

mund të kryhet kjo vepër janë caktuar në mënyrë alternative të cilat konsistojnë në shitjen ose në dhënien e materialeve ose sendeve me përmbajtje pornografike.

Marrëdhëniet seksuale brenda familjes

Familja është bashkësi vitale e prindërve dhe fëmijëve të tyre si dhe personave tjerë në gjini. Marrëdhëniet juridike në familje janë të rregulluara me ligj, dhe e njëjta duhet të respektohet dhe të mbrohet. Mardheniet seksuale mbrenda familjes janë denueshme dhe paraqesin veper penale të parapara në Kodin penal të Republikës së Maqedonise në (nenin 194).

Historikisht botëkuptimi lidhur me mardhëniet seksuale në familje kanë ndryshuar.⁴⁶E drejta zakonore mardhëniet seksuale në mes të antarëve të familjes i ka konsideruar si vepra të rënda. Lidhur me zbulimin e këtyre mardhënieve parashtrohen veshtiresi të konsiderueshme dhe tregohen edhe pasoja lidhur me mardheniet familjare gjatë procedurës së ndjekjes. Si rezultat i këtyre diskutimeve ka shtyre disa shtete të heqin dorë nga ndeshkimi i këtyre mardhënieve, si; (Franca, Portugalia, Belgjika), mirëpo incesti mbetet i ndëshkueshëm në shumë shtete si, (Italia, Danimarka, Greqia etj).

Incesti, dtth; mardhënie seksuale me pelqim(deshirë), në mes të antareve të familjes në vije të drejtë dhe në vije të tërthortë të gjakut.⁴⁷ Andaj, shkaqet e inkriminimit të këtyre mardhënieve, kryesisht janë të natyrës morale dhe shëndetësore. Legjislacionet që e inkriminojnë incestin si vepër nuk dallojnë shumë sa i përket elementeve të formës së thjeshtë të kësaj vepre penale.

Këte veper penale e kryen ai i cili do të kryejë aktin seksual me të afërt prej gjaku në vije të drejtë apo me vëlla përkatësisht me motër dhe do të dënohet me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet (n.194, par.1 i KPM-se)

Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer me të mitur që ka mbushur 14 vjet kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim. (n.194,par.1 i KPM-se.

⁴⁶ Po aty

⁴⁷ Po aty

Arsësyet e inkriminimit të kësaj vepre janë të shumta.⁴⁸ Së pari, cënohet morali i familjes dhe i shoqërisë, më pas me këtë vepër shkaktohen çrregullime në mardhëniet familjare, si dhe pasoja negative në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Gjithashtu, në shkencën e mjekësisë është konstatuar se nga mardhëniet e këtilla seksuale krijohet rreziku i madhë që të lindin fëmijë të degjeneruar, me anomali fizike dhe psiqike.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale nuk është me rëndësi se në çfarë shkalle të gjinisë së gjakut është fjala, me rëndësi është që të ekzistojë gjini e gjakut në vijë të drejtë.⁴⁹ Poashtu, nuk është e rëndësishme nëse është fjala për gjini gjaku në martesë ose jashtë martesës. Ndërkaq në vijën e tërthortë kjo vepër penale mund të kryhet vetëm ndërmjet motrës dhe vëllait. Edhe te kjo formë e veprës nuk është e rëndësishme nëse vëllai dhe motra ose njëri prej tyre ka lindur në martesë apo jashtëmartese. Kjo vepër nuk konsiderohet se ekziston nëse është kryer midis të afërme në gjininë e tërthortë jashtë shkallës së parë të gjinisë.

Procedura penale fillon sipas detyrës zyrtare, andaj çdokush që ka dijeni që është kryer kjo vepër penale, duhet të lajmëroj në organet e ndjekjes dhe prokurori është i obliguar të fillojë procedurën penale.⁵⁰

Në vijim do të paraqesim vendimin gjyqesor(pjese aktgjykimit) të shqiptuar nga Gjykata themelore në Tetovë për kryreje të veprës penale të dhunimit me datë, 19.2.2016.

“(NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Gjykata Themelore Tetove, si gjykatë e shkallës së parë ne perberje; Mr.V.K-gjyqtare e vetme dhe procesmbajtese Z.J, duke vepruar sipas aktakuzes se PPTH nga Tetova KO.nr.123/16 te dt.12.06.2016, kundër të akuzuarit A.T, nga fshati P....., për vepër penale të DHUNIMIT, sipas nenit 186.parag.5., pas mbajtjes së seancës kryesore, publike dhe gojore në prezencë të prokurorit publik Z.K, të pandehurit dhe

⁴⁸ I.Saliu, Edrejta penale, pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009, fq.235

⁴⁹ Po aty

⁵⁰ Po aty

mbrojtësit e tij N.D.,NGA Tetova, te pandehures dhe mbrojtësit te saj nga E.M, nga Shkupi, gjykata solli këtë;

A K T G J Y K I M

I A K U Z U A R I;

A.T i lindur me dt....., me vendbanim të përhershëm në fshatin ----, i pa martuar, i pa punësuar, përgatitja shkollë- shollën fillore te mbaruar, i pa denuar me pare, shqiptarë, shtetas i R.Maqedonisë, me nr,personal----- është;

F A J T O R

S E P S E;

Me datë 03.02.2016 rreth orës 17,15 në fsh, P-----,Komuna e T.....me përdorimin e forcës ka kryer veprim seksual ndaj S.R, shtetase e huaj, me venqëndrim në të njëjtin fshat te shtëpia e S.R.I pandehuri A.T -e ka ndjekur viktimën derisa ecte nëpër fshat në drejtimin e xhamisë së fshatit, duke iu ofruar se dëshiron ta pershendet, në atë mënyrë që ia ka zgjatur doren viktimes.E dëmtuara në momentin kur ia ka kthyer pershendetjen, i pandehuri me force tenton ta prekë në pjesë të trupit, në gjestin e të cilit e dëmtuara e ka kundërshtuar duke rezistuar, duke tentuar te largohet, të ikë nga vendi i ngjarjes, por i pandehuri ka arritur ta rëzoj në pllakat e bekatonit në rrugë dhe ka vazhduar ta preke në pjesët intime të trupit të të dëmtuarës. Në momentin kur e dëmtuara nuk ka mundur pas së cilës e dëmtuara ka filluar të kërkojë ndihmë me zë të lartë, pas së ciles i pandehuri edhe është larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

Me veprimet e mësipërme i pandehuri S.R. ka kryer vepër penale DHUNIMI të nenit 186 paragraf.5 dhe nenit 45 të Kodit Penal, kështu që gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të cituara nga nenet 32, 33, 35, dhe 39, të Kodit Penal, gjykata te akuzuarin e :

D Ë N O N

ME DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ-1 vjet e gjashte muaj

Koha e kaluar në paraburgim që nga 11.02.2016 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit të llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

A R S Y E T I M

I Akuzuari Z.J nga fsh.P-----, gjatë procesit gjyqësor, pas udhëzimit për të drejtat e tij si i akuzuar në procesin gjyqësor, u deklarua se e kupton aktakuzën në terësi

I akuzuari e pranoi fajin, si dhe i kerkoi falje të demtuarës.

Procesmbajtëse;
Z.J

Kryet.i këshillit-gjykatësi
V.K

KESHILLA: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditëve nga marja e të njëjtit deri te Gjykata e Apelit në Gostivar.

KAPITULLI I TRETË

1. Kryerësit e veprave penale të dhunimit

1.1. Mosha e kryerësve të veprës penale të dhunimit

Lidhja ndërmjet moshës dhe kriminalitetit është studiuar shumë kohë më parë. Këteleja (Quetele) e vlerëson moshën si një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në tendencat e krimit. Tendenca më e theksuar e krimit zhvillohet në proporcion me intensitetin e forcës fizike dhe pasionin e personit⁵¹. Në përgjithësi është pranuar se në vendet ku ka probleme të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve, të mungesës së rendit dhe të stabilitetit politik dhe ekonomik, mundësitë e përfshirjes në krim në mosha të hershme janë të mëdha⁵².

Kryerës të delikteve seksuale në pjesën më të madhe janë personat e moshës së re.⁵³ Sipas kërkimeve empirike dhe shënime statistikore kriminale të disa shteteve, si Austri, Gjermani, Angli etj, zakonisht kryerësit e këtyre delikteve janë persona të moshës së re. Kështu, krimin e dhunimit seksual në 7% e kryejnë personat mitur, në 17%, të rasteve të miturit e rritur, në 50% të rasteve krimet seksuale i kryejnë te rriturit prej moshës 18-30 vjeç, ndërsa 25% të rasteve këto krime i kryejnë personat prej moshës 30-40 vjeç.

Ndërsa sa i perket personave të denuar sipas perkatesise nacionale të denuar për vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor sipas të dhënave statistikore të marra nga Enti

⁵¹ I.Zejneli;vep,e cituar, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018,fq.118

⁵² Po aty;

⁵³ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008,fq.191, vepër e cit.

statistikor Republiken i Maqedonisë është si vijon;⁵⁴ gjithsej 39 persona, 15 maqedonas, 4 shqiptar, 2 turq, 8 rom, 1 te tjerë dhe 9 të panjohur.

Në vijim do të paraqesim të dhëna nga Enti statistikor Republiken⁵⁵ për persona të dënuar për kryerjen e veprës penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, sipas moshës dhe gjinisë ku bën pjesë edhe vepra penale e dhunimit-

Gjithsej			18-20vj.		21-24vj.		25-29vj.	
	M	F	M	F	M	F	M	F
Gjithsej	38	1	7	1	6	-	5	-
Të dënuar më parë	7	-	-				1	
Për veprë të njëjtë	4	-	-				-	
Për vepra të ngjajshme	3	-	-				1	

1.2. Gjinia e kryerësve të veprës penale të dhunimit

Studimi i autorëve të veprave penale dhe vëmendja e kriminologëve ka ngjallur interesim dhe është drejtuar në studimin e lidhjeve si: femra dhe krimi, të miturit dhe krimi si dhe janë përpjekur të shpjegojnë dallimin e madh që ekziston në përfshirjen e meshkujve dhe të femrave në krim, jo vetëm në vendet perëndimore por edhe në ato në zhvillim ose të Evropës Jug-Lindore⁵⁶.


Si kryerës të krimeve seksuale, në bazë të shënimeve statistikore zyrtare të shumë shteteve më së shpeshti paraqiten personat e gjinisë mashkullore.⁵⁷

⁵⁴ Statisticki pregled, 2.4.17.09(878)

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ V. Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, faqe 123;

⁵⁷ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.191, vepra e cit.



1.3.Rrethi familjari kryerësve të veprës penale te dhunimit

Familja është grup themelor shoqëror i njerëzve i lidhur me martesë dhe gjini, midis të cilëve ekzistojnë të drejta dhe detyra të parashikuara me ligj.⁵⁸

Familja si bashkësi shoqërore, paraqet faktorin më me rëndësi në zhvillimin dhe formimin e personalitetit të njeriut. Familja si institucion i veçantë shoqëror përherë ka pasur dhe tani ka funksione dhe detyra të shumëllojshme në formimin, edukimin, ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet e, sidomos të fëmijëve dhe të rinjëve⁵⁹.

Në preambulën dhe në nenet 5, 10 dhe 18-të, Konventa për të drejtat e fëmijëve në mënyrë të veçantë i referohet familjes si grup themelor i shoqërisë dhe si mjedis i natyrshëm për

Në Gjermani, prej 18.119 rasteve të personave të akuzuar për dhunime seksuale, vetëm 8% kanë qenë femra, ndërsa në numrin e përgjithshëm të personave të dënuar për krime seksuale femrat marrin pjesë me vetëm 3%. Kjo do të thotë se 90,5% të tëra krimeve seksuale me dhunë i kryejnë meshkujt. Meshkujt kryejnë krime të dhunimeve seksuale, mardhënieve seksuale me persona të mitur, mardhënie seksuale që janë në pozitë të varshmërisë, ndërsa femrat kryejnë zakonisht krime seksuale që kanë të bëjnë me organizimin e prostitucionit ose disa veprimeve të turpshme, ose organizimin e pornografisë dhe keqpërdorimit e të miturve dhe të fëmijëve për qëllime fitimi.

⁵⁸ A. Aliu&H. Gashi,E drejta familjare,Prishtinë,2007,fq.41

⁵⁹ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq. 276;

rritjen dhe mirëqenien e antarëve të saj, në mënyrë të veçant për fëmijët. Shtetet janë të obliguara t'u rrespektojnë përgjegjësinë primare të prindërve për ofrimin e kujdesit dhe udhëzimeve ndaj fëmijëve të tyre dhe ti përkrahin ato duke u dhënë mbështetje të përgjithëshme. Shtetet palë rrespektojnë përgjegjësitë, të drejtata dhe detyrat që kanë prindërit ose sipas rastit antarët e familjes së zgjeruar, kujdestarët ose personat e tjerë që janë sipas ligjit përgjegjës për fëmijët, për t'iu siguruar atyre në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave të njohura në këtë Konventë(n.5).⁶⁰

Familja është bazë e fortë e çdo shoqërie, familja e shëndoshë do të thotë shoqëri e shëndoshe dhe stabile.⁶¹Familja në të cilën mbretëron harmonia, raportet e mira dhe të drejtat në mes të antarëve, sidomos mardhëniet e mira dhe të ngrohta në mes të prindërve dhe fëmijëve, janë garancë e fortë se më pak do të ketë sjellje devijante dhe kriminale të fëmijëve dhe të të miturive dhe në të njëjtën kohë besueshmëri se më pak do të viktimizohen antarët e familjes.

1.4.Niveli arsimor i kryerësve të veprës penale te dhunimit

Kërkimet e ndryshme lidhur me kryerësit e krimeve të dhunës seksuale, konstatojnë se si kryerës paraqiten personat me pergatitje të ulët shkollore.⁶²Ndërsa shiquar sipas sezonës me tepër ndodhin gjatë muajve të verës, ndërsa shiquar sipas kohës ato ndodhin më shumë natën se sa ditën.Theksohet se lidhur me kryerjen e këtyre krimeve, edhe te kryerësi edhe te viktima, shpesh kemi të bejmë me persona të cilët kanë përdorur alkoolin ose ndonjë pije tjetër stimuluese. Sipas nenit 28 të Konventës mbi të drejtat e Fëmijës sanksionohet e drejta e fëmijës për arsim. Arsimi fillor duhet të jetë i detyruar dhe pa pagesë. E drejta për arsim është e njohur si

⁶⁰ I.Zejneli, Delikuenca e te miturve, Tetove,2018,fq.154

⁶¹ R. Halili, Viktimologjia, Prishtinë, 2011, faqe 74

⁶² R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, faqe 276;

Sipas një studimi 90% te delikteve seksuale janë me shkollë fillore, me profesion punetorë të pakualifikuar ose të papunë. Ne shume raste, kryerësit e dhunimeve seksuale më parë e kanë njohur viktimën e tyre. Krimet seksuale kryhen më tepër në qendrat dhe qytetet e mëdhaja se sa në viset fshatare dhe në qendrat e vogla. Kësisoj, kërkimet e ndryshme të bëra në Gjermani, vërtetojnë se dhunimet seksuale paraqiten më tepër ne qytete mbi 500.000 banore, pastaj vijnë qytetet me me pak se 200.000 banore, kështuqë numri krimeve të dhunimeve seksuale vjen duke rënë sipas zvoglimit të banorëve të qyteteve apo vendbanimeve.

një e drejtë themelore për të gjithë fëmijët “mbi bazën e mundësive të barabarta”. Parashihen detyrimet e shteteve që të marrin të gjitha masat për të ulur numrin e nxënësve që braktisin shkollën, dhe të sigurojnë që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

1.5.Përgatitja shkollore e kryerësve të veprës penale të dhunimit

Shkolla nuk është thjesht një vend ku të miturit marrin dije por edhe një ambient ku kalojnë një pjesë të mirë të kohës së tyre dhe ku krijojnë konceptet bazë mbi autoritetin, mardhëniet me moshatarët dhe rregullat e sjelljes në komunitet.⁶³


Në vijim do të paraqesim të dhëna nga Enti statistikor Republikan⁶⁴për persona të dënuar për kryerjen e veprës penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, sipas moshës dhe gjinisë ku bën pjesë edhe vepra penale e dhunimit.

	Gjithsej	Pa përgatitje shkollore	4-7 klase të mbaruara	Shkollën e fillore të mbaruar	Shkollën e mesme të mbaruar	Shkollën e lartë të mbaruar	Fakultetin e mbaruar	E panjohur
Gjithsej	39	6	3	10	14	-	1	5
Femra	1	1	-	-	-	-	-	-

Nga tabela do të vërejmë se vepra penale të këtij grupi më së tepërmi kanë kryer personat pa përgatitje shkollore.

⁶³ Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa e të drejtave të njeriut, Tiranë, f.482

⁶⁴ Statisticki pregled, 2.4.17.09(878)



Nga tabela do të vërejmë se vepra penale të këtij grupi më së tepërmi kanë kryer personat pa përgatitje shkollë.

2. Viktimat e veprave penale të dhunimit

2.1. Mosha e viktimave të veprës penale të dhunimit

Viktima të krimit duhet të konsiderohen çdo person fizik të cilit në mënyrë direkte apo indirekte i është cënuar, rrezikuar apo shkaktuar ndonjë dëm në të drejtat e tij.⁶⁵ Kuptimi i viktimës ndodh që të mos përputhet me kuptimin e të demtuarit në procedurë penale, sepse atje si viktimë apo të demtuar konsiderohen vetëm personat kur kryerësi i veprës penale është identifikuar dhe ndaj tij zhvillohet procedura penale, ndërsa në viktimologji si viktimë

⁶⁵ R.Halili, Viktimologjia, Prishtinë, 2007, fq.48 veper e cit.

konsiderohen të gjithë ata që kanë pësuar nga aktiviteti kriminal, pa marrë parasysh faktin se a dihet kryerësi i atij aktiviteti kriminal.

Z.Sheparoviç, mendon se si viktimë e krimit duhet të konsiderohet çdo person fizik të cilit ndonje e mirë apo e drejtë në mënyre direkte i është cënuar me anë të kryerjes së veprës penale.⁶⁶ Autori tjetër Vouin-Laute mendon se viktimë e krimit konsiderohet ai person fizik të cilit i është atakuar apo rrezikuar ndonjë e mirë apo e drejtë me ndonjë vepër penale.

Mosha e viktimave të krimeve seksuale, sipas kërkimeve të bëra gjithashtu është moshë e re, zakonisht sillet prej 14-25 vjeç. Këtë konstatim e vërtetojnë kërkimet e bëra në shumë shtete si Gjermani, Austri, Zvicër, Angli, SHBA, Kanada, Kroaci etj. Sipas një kërkimi të bërë në Kroaci, vërtetohet se 44% të viktimave janë prej moshës 14-18 vjeç, 22% të viktimave janë të moshës 18-30 vjeç, 12% të viktimave janë prej moshës 30-40 vjeç, 10% të viktimave janë të moshës 40-60 vjeç dhe vetëm 6% të viktimave janë të moshës më të vjetër.⁶⁷

Personat prej 3 deri në 7 vjet, poashtu konsiderohen si mjaft të atakuar nga lloj-lloj abuzimesh. Kjo kategori i nënshtrohet dhunës fizike dhe psiqike dhe abuzimit seksual, shpeshherë brenda familjes. Këtë grupmoshë të viktimave e hasim në rastet e keqtrajttimeve fizike, dhunës dhe keqtrajtimit fizik e psiqik, abuzimit seksual në kopshte, çerdhe fëmijësh, qendra për strehim, jetimore, qendra parashkollore, qendra për rehabilitimin e fëmijëve me hendikepe të ndryshme etj. Viktimizimi nga veprimet e pedofilëve brenda dhe jashtë familjes në këtë grupmoshë është gjithashtu shumë i theksuar.⁶⁸

Personat prej 7 deri 14 vjet, që përfshinë fëmijët, poashtu janë shumë të prekur nga viktimizimi me krime seksuale. Të dhënat statistikore vendore e botërore e dëshmojnë këtë gjë se pikërisht kjo grupmoshë viktimizohet nga veprimet kriminale në lloje të ndryshme të keqtrajttimeve dhe keqpërdorimeve seksuale, përdorimit në inçizime dhe materiale pornografike, abuzimit seksual nga pedofilë, etj. Fatkeqësisht, gjatë 2-3 viteve të fundit, mediat e shkruara dhe ato elektronike janë përplot me raste të aferave dhe skandaleve të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të nxënësve, të të miturve dhe të fëmijëve të kësaj moshe nëpër shkolla kishtare,

⁶⁶ Po aty

⁶⁷ R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2008, fq.191, veper e cit.

⁶⁸ R.Halili, Viktimologjia, Prishtinë, 2011, fq. 50.

konvikte të manastireve apo qendra të tjera të karakterit të mbyllur, ku jetojnë dhe mësojnë këta fëmijë.⁶⁹

2.2. Gjinia e viktimave të veprës penale të dhunimit

Gjinia femërore, vetitë e femrës në literaturën viktimologjike shpesh konsiderohen si veti viktimogjene të parapërcaktuara.⁷⁰ Femra më shumë se meshkujt i është ekspozuar rrezikut të viktimizimit në jetë. Arësyet dhe faktorët që ndikojnë në viktimizimin e saj janë të ndryshme kështu, disa autorë konstatojnë se femra, për nga natyra e saj është e parapërcaktuar të jetë viktimë, trupi i femrës dhe funksioni i saj ndikojnë që ajo më shpesh të bëhet viktimë e raporteve të ndryshme.

Në vijim do të paraqesim të dhëna nga Enti statistikor Republikan⁷¹ për persona të dënuar sipas mosheë dhe gjinisë për kryerjen e veprës penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, ku bën pjesë edhe vepra penale e dhunimit-.


	Gjithsej	te Persona njohur	Femra	Aktakuza eshte hudhur poshte	Procedura eshte pushuar	Procedura eshte nderprere	Aktakuza eshte ngritur	te Persona panjor
Gjithsej	88	78	-	16	-	6	56	10
Dhunimi	27	23	-	6	-	1	16	4
Sulm ndaj personave qe nuk i kane mbush 14 vjet.	30	28	-	2	-	5	21	2
Te tjere	31	27	-	8	-	-	19	4

⁶⁹ Po aty. fq.51.

⁷⁰ Po aty, fq.76

⁷¹ Statisticki pregled, 2.4.17.09(878)

Nga tabela do të vërehet se kryerësit e veprës penale të dhunimit në 23 raste personat janë të njohur, ndërsa në 10 raste personat janë të panjohur. Në 56 raste është ngritur aktakuzë nga ana e prokurorit publik, ndërsa në 16 raste e njëjta është hedhur poshtë.



Nga tabela do të vërehet se kryerësit e veprës penale të dhunimit në 23 raste personat janë të njohur, ndërsa në 10 raste personat janë të panjohur. Në 56 raste është ngritur aktakuzë nga ana e prokurorit publik, ndërsa në 16 raste e njëjta është hedhur poshtë.

KAPITULLI I KATËRT

1. Luftimi dhe Parandalimi i veprave penale të dhunimit

Është fakt se nga kriminaliteti, si dukuri shoqërore negative, nuk ka qenë dhe aktualisht nuk është imune asnjë shoqëri, pa marrë parasysh kohën e veprimit të saj dhe pa marrë parasysh rregullimin shoqëroro-politik të saj. Edhe sot çdo shoqëri njerëzore e organizuar në shtet nëpërmjet institucioneve të ndryshme (familjes, shkollës, organeve të kujdesit social, të entiteteve të tjera joqeveritare dhe medimeve) ndërmerr masa preventive me të cilat synon të pengojë kryerjen e veprave penale. Nuk ka dyshim se procesi i tillë i reagimit ndaj kriminalitetit është proces kompleks dhe i ndërlikuar por, i domosdoshëm. Megjithatë, nuk duhet pritur që procesi edukativ-preventiv, sa do i rëndësishëm që është, të sjell deri te pengimi dhe zhdukja e plotë e kriminalitetit. Në këtë drejtim është domosdoshmëri që shteti të angazhohet edhe në aspektin tjetër, në aspektin “represiv” të reagimit ndaj kriminalitetit. E quajmë represiv sepse procedura penale, zbatohet kundër kryerësit të veprës penale pavarësisht nga vullneti i të pandehurit dhe, sipas rregullit, pavarësisht nëse këtë e dëshiron i dëmtuari. Prandaj, masat e reagimit kundër kriminalitetit të cilat ndërmerren në procedurë penale, sikurse gjithë veprimtaria në fushën juridiko penale, i përkasin masave “represive” në kuptimin e theksuar më sipër. Ligjvënësi duke inkriminuar veprimet që cenojnë rregullimin juridik dhe të drejtat e individit- duke paraparë veprat penale, sanksionet penale dhe kushtet nën të cilat sanksionet penale mund të shqiptohen, si dhe duke e rregulluar procedurën penale kërkon nga organet shtetërore t’i shqiptojnë dhe t’i ekzekutojnë sanksionet penale ndaj kryerësve përgjegjës të veprave penale.⁷²

Duke vepruar kështu efektivisht mund të ndikohet në pengimin e kriminalitetit në një anë dhe të bëhet ndëshkimi i atyre ndaj të cilëve masat preventive nuk kanë dhënë rezultat për moskryerje të veprave penale. S’ka dyshim se luftimi me sukses i kriminalitetit, që nënkupton

⁷² E.Sahiti&I.Zejneli, E drejta e procedurës penale e Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.107

ndjekjen dhe ndëshkimin e kryerësve penalisht përgjegjës për veprën penale në anën tjetër, pozitivisht reflektohet në mbrojtjen dhe përforcimin e marrëdhënieve të shëndosha shoqërore, në mbrojtjen e të drejtave të entiteteve, në mbrojtjen e të drejtave të individit dhe të grupeve të individëve⁷³.

Me parandalimin e kriminalitetit merren shumë organe shtetërore, institucione, si forca të posaçme preventive.⁷⁴ Në luftimin e procesit preventiv të kriminalitetit është me rëndësi të madhe të përcaktohen prerazi dhe konkretisht rolet, detyrat dhe qëllimet e subjekteve të caktuara të aktivitetit parandalues. Sistemi i prevencionit shoqëror duhet të ketë mbështetje shkencore dhe duhet të fillojë nga analizat shkencore dhe nga përpunimi i masave për sërmdertimin e determinanteve sociale të dukurive antishoqërore e sidomos të sjelljeve të inkriminuara.

Për ta penguar dhe parandaluar viktimitetin, patjetër duhet të studiohen dhe analizohen faktorët dhe shkaktarët e tij.⁷⁵ Nga elaborimet mbi faktorët e viktimitetit apo viktimizimit, është vërejtur se në viktimizimin e njeriut ndikojnë në rend të parë, kushtet dhe rrethanat që kontribojnë në viktimizimin e njeriut. Prandaj, zgjedhja e problemeve të kësaj natyre nga ana e autoriteteve shtetërore do të ndikonte dukshëm në evitimin e faktorëve që çojnë drejt viktimizimit.

Parandalimi i krimit nuk është diçka e thjeshtë, përkundrazi ai është tepër i ndërlikuar dhe i thjeshtë.⁷⁶ Derisa kriminaliteti shfaqet në forma dhe mënyra të ndryshme, edhe masat për parandalimin e tij duhet të jenë të gjithëanshme dhe të diferencuara. Në aspektin e përmbajtjes,

⁷³ Po aty

Ndërmarrja e masave në uljen e shkallës së varferisë dhe zgjedhjen e problemit të papunësisë enorme në nivelin nacional, por edhe global, është detyrë imadiate e çdo shteti, por edhe e komunitetit ndërkombëtar. Varfëria, skamja, papunësia, konfliktet, dyndjet, migrimet e popullsisë, janë burime të pandërprera të pakenaqësive. Dallimet e mëdha në mes të varfërve dhe të pasurve, diskriminimet në baza etnike, fetare, politike, racionale, kanë nxitur një valë të madhe të pakenaqësive, mostolerancës dhe dukurive të tjera, të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi po kontribojnë në viktimizimin e njeriut në të gjitha viset e botës. Prandaj, parakusht i parandalimit të viktimizimit është zgjedhja e këtyre problemeve, duke ofruar prespektivë për të gjithë. Kjo do të ndihmonte uljen e shkallës së varferisë, papunësisë, zvogëlimin e tendencave për migrim dhe lëvizje masive të popullatës. Kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ulë rastet e trafikëve me njerëz, me gra, me fëmijë, marrjen me veprimtari tjera të krimit të organizuar, nga të cilat edhe numri i viktimave deri tani ka qenë i madh.

⁷⁴ V. Latifi, Politika kriminale, Prishtinë, 2008, fq. 112

⁷⁵ R. Halili, Viktimologjia, Prishtinë, 2007, fq. 150

⁷⁶ A. Dervishi, Policia perballe realitetit, Tirane, 2003

Lufta kunder kriminalitetit nuk është detyrë e dy apo tre organeve të specializuara, por e të gjitha organeve shtetërore dhe të gjitha shtetaseve. Praktika tregon se shkelja e ligjit ose tolerance në dem të tij, krijon të cara që shfrytëzohen nga elementet keqbërëse.

masat parandaluese janë të një game mjaft të gjërë, ata mund të jenë të karakterit juridik, politik, edukativ, arsimor, organizativ etj.

2. Roli i policisë në parandalimin e veprave penale të dhunimit

Policia është organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, mbajtjen e rendit, dhe të qetësisë publike si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetëror.⁷⁷ Policia është një institucion tradicional i njohur për mbrojtjen e rendit shoqëror në të gjitha tipet historike shoqërore në të gjitha vendet e botës. Policia është e obliguar ti hetojë veprat dhe situatat që janë të përshtatshme për paraqitjen e veprave penale, ti identifikojë grupet kriminale dhe të marrë masa për kapjen e tyre. Kjo është e domosdoshme për parandalimin e organizimit në luftimin dhe trajtimin e të gjitha llojeve të kriminalitetit.

Detyrat e përgjithshme të policisë janë të ⁷⁸ mbrojtjet, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat; mbrojtje të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave; parandaloj rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike; parandaloj dhe t'i zbuloj veprat penale dhe kryerësit e tyre; hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre; mbikëqyrë dhe kontrolloj sigurinë në komunikacion; menaxhoj dhe kontrolloj kufirin shtetëror; ofroj ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe kryej detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.

Veprimtaria e policisë është e shumëfishtë. Policia, duke vepruar në parandalimin dhe zbulimin e krimit i ofron prokurorit publik dhe gjykatës material të nevojshëm për fillimin e procedurës penale; gjatë zhvillimit të procedurës penale afron ndihmë kriminalistike lidhur me identifikimin e personave dhe të sendeve (marrja e shënjave të gishtërinjve, marrja e materialit biologjik për analizë të ADN-së, etj); afron ndihmë për ekzekutimin e vendimeve; jep të dhëna nga evidencat e caktuara etj.⁷⁹

⁷⁷ R.Halili, Viktimiologjia, Prishtinë, 2007, fq.150

⁷⁸ N.10, i Ligjit për policinë e Kosovës

⁷⁹ E.Sahiti&I.Zejneli, E drejta e procedurës penale e Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.107

Ne vijim do te paraqesim te dhena te marra nga Ministria e Puneve te mbredshme lidhur me vepra penale te dhunimit.⁸⁰ per periudhen 2010-2016

Gjendja e delikteve seksuale							
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Vepra penale e dhunimit	28	41	43	38	45	42	36
Kryerës	31	39	36	36	48	33	33
Perqindja në 100.000 banorë	1.28	1.87	1.96	1.73	2.17	2.02	1.73
Sulm seksual ndaj fëmijëve	61	35	34	47	43	38	30
Kryerës	71	37	35	51	54	38	28

Nga tabela e mësipërme e të dhënave të marra nga Ministria e Punëve të Mbredshme e Republikës së Maqedonisë, do të vërejmë se më shumë vepra penale të dhunimit janë kryer në vitin 2014.

Vepra penale e dhunimit sipas sektoreve							
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
SPB Shkup	1	2	8	5	5	10	6
SPB Manastir	3	8	3	4	5	8	4
SPB Veles	2	4	3	6	11	3	4
SPB Kumanovë	7	5	5	3	5	6	3
SPB Ohër	/	/	1	3	10	4	4

⁸⁰ Të dhëna statistikore, nga Ministria e punëve të mbredshme e R.Maqedonisë

SPB Strumicë	4	9	6	7	2	3	6
SPB Tetovë	4	2	2	2	/	3	3
SPB Shtip	7	11	15	8	7	5	6

Nga tabela do vërejmë se, nëse e krahasojmë kryerjen e veprës penale sipas sektorëve, do të vërejmë se, në teritorrin e Tetovës janë kryer më pakë vepra penale të dhunimit se sa në sektorët tjerë të vendit në tërë teritorin e Republikës së Maqedonisë.

Policia si institucion shtetëror në shoqërinë demokratike është krijuar për t'i shërbyer individit dhe komunitetit.⁸¹ Misioni i saj i shprehur në ligj është mbrojtja e individit, shtetit dhe komunitetit. Atributi kryesor i saj është; mbledhja dhe administrimi i informacionit, kontrolli i identitetit, hyrja në mjedise, thirrja dhe shoqërimi i personave, arrestimi dhe ndalimi i personit.

3. Roli i prokurorisë së shtetit në parandalimin e veprave penale të dhunimit

Duke u bazuar në parimin akuzator, sipas të cilit nuk ka gjykim pa paditës (*nemo iudex sine actore*), procedura penale nuk mund të zhvillohet pa akuzë të paditësit të autorizuar.⁸² Në të drejtën e Republikës së Maqedonisë prokuroria publike është organ shtetëror i unisuar dhe i pavarur, i cili ndjek kryerësit e veprave penale dhe të veprave tjera ndëshkuese dhe kryen edhe punë të tjera të parashikuara me ligj. Prokuroria publike i kryen funksionet e veta në bazë të kushtetutës dhe ligjit (neni 106 i Kushtetutës së RM). Mbështetur në nenin 39 të LPP-së, e drejtë dhe detyrë themelore e prokurorit publik është ndjekja e kryerësve të veprave penale. Në kuadër të realizimit të kësaj të drejte dhe detyre prokurori publik ka mundësi të ndërmerr një vag veprimesh konkrete. Në këtë drejtim ai duhet të ndërmerr masat e nevojshme lidhur me zbulimin e veprave penale dhe gjetjen e kryerësve të veprave penale dhe të inicojë procedurën penale; në procedurë parahetimire, nën kushtet e përcaktuara me ligj, jep urdhëra për zbatim të masave të

⁸¹ B. Yzeiri, Menaxhimi i policisë, Tirane, 2003, fq.13

⁸² E.Sahiti&I.Zejneli, E drejta e procedurës penale e Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.105

posaçme hetimore; zhvillon hetimin e veprave penale; ngritë dhe përfaqëson akakuzë apo propozimakuzë në gjykatë kompetente; bën ankesë kundër vendimeve gjyqësore që nuk e kanë formën prerë dhe paraqet mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Përveç funksionit të hetimit dhe të ndjekjes së veprave penale në procedurë penale, në planin e gjerë të luftës kundër kriminalitetit, prokuroria publike ka të drejtë dhe për detyrë t'i përcjell dhe t'i studiojë marrëdhëniet dhe dukuritë shoqërore të rëndësishme për realizimin e funksionit të tyre dhe, për vrojtimit e veta, ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të jep propozime për parandalimin e dukurive të rrezikshme dhe të dëmshme për shoqërinë si dhe për përforcimin e sundimit të ligjit. Prokuroria publike po ashtu ka të drejtë dhe për detyrë që ta informojë opinionin lidhur me gjendjen e kriminalitetit dhe për problemet dhe dukuritë tjera me rëndësi të përgjithshme, të cilat i ka vërejtur në punën e vet. Informimi mund të bëhet edhe për rastet konkrete në të cilat vepron, por në kufijtë ligjor dhe në harmoni me interesat e procedures.⁸³


Në vijim do të paraqesim të dhëna për persona të paraqitur për kryerje të veprës penale kundër lirisë dhe morali gjinor.⁸⁴

	2012	2013	2014	2015	2016
Veprat penale kunder lirise gjinore dhe moralit gjinor	109	108	88	74	88

⁸³ Po aty

⁸⁴ Statisticki pregled, 2.4.17.09(878)

Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor



Ndërsa, aktakuzë për kryerje të veprës penale kundër lirisë dhe morali gjinor, ku bën pjesë edhe vepra penale e dhunimit është ngritur, në rastet, si në vijim;

	2012	2013	2014	2015	2016
Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor	54	78	65	60	45

4. Roli i gjykatave në parandalimin e veprave penale dhunimit

Gjykata është subjekt themelor i procedurës penale. Ajo në procedurë penale e ushtron funksionin e gjykimit, mirëpo funksioni i saj nuk kufizohet vetëm në funksionin e gjykimit. Gjykata si organ i pavarur gjykon në bazë të kushtetutës dhe ligjit dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.⁸⁵

Praktika e gjykatave është e nderlidhur me legjislacionin penal dhe me qëndrimin e se drejtes penale.⁸⁶ Kur gjykatesi e shqyrton një lende të caktuar, ai është i obliguar të zgjedhë në

⁸⁵ E.Sahiti&I.Zejneli, E drejta e procedurës penale e Maqedonisë, Shkup,2017,fq.105


⁸⁶ V. Latifi, Politika kriminale, Prishtinë,2008, fq.131

mesin e shume alternativave ato mundesi qe i ofron norma penale, pra ate qe me se tepermi qendron ne funksionin e qellimeve te politikës ndeshkimore. Aktiviteti gjyqesor eshte shume i nderlikuar, i ndjeshem dhe suptil, ai vendos per ceshtje te rendesishme te njeriut dhe shoqerise, andaj nuk duron arbitraritet as kunderthenie qe jane inkopatibile me funksionin gjyqesor.

Ne vijim do te paraqesim te dhena per persona te denuar per kryerje te vepres penale kunder lirise dhe morali gjinor.⁸⁷

	2012	2013	2014	2015	2016
Veprat penale kunder lirise gjinore dhe moralit gjinor	47	64	49	56	39

Për vepër penale të dhunimit janë dënuar gjithsej 14 persona, prej të cilëve në 12 raste është shqiptuar dënimi me burgim; për kryerje të veprës penale ndërmjetësim në prostitucion janë dënuar gjithsej 2, persona, prej të cilëve njëra ishte e gjinisë femrore.⁸⁸



⁸⁷ Statisticki pregled, 2.4.17.09(878)

⁸⁸ Po aty

Per veper penale te dhunimit jane denuar gjithsej 14 persona, prej te cileve ne 12 raste eshte shqiptuar denimi me burgim; per kryerje te vepres penale ndermjetesim ne prostitucion jane denuar gjithsej 2, persona, prej te cileve njera ishte e gjinise femrore.⁸⁹

Organet e gjykatës veçmas janë të obliguara të nxjerrin dhe të zbatojnë vendime për mbrojtjen e të drejtave të viktimave gjatë tërë kohës së zgjatjes së procesit gjyqësor apo edhe pas përfundimit të tij lidhur me rastin viktimizues.⁹⁰ Këto masa kanë të bëjnë me urdhëresa apo vendime për mbrojtjen emergjente fizike të viktimave, për siguri fizike dhe psikike të tyre për ndalimin e qasjeve dhe shqetësimeve të viktimizuesëve apo personave tjerë ndaj viktimave.

Në vijim do të paraqesim vendimin gjyqësor(pjese aktgjykimit) të shqiptuar nga Gjykata themelore në Tetovë për kryerje të veprës penale të dhunimit me datë, 1.12.2017.

“(NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Gjykata Themelore Tetove, si gjykatë e shkallës së parë ne perberje; S.I-Kryetar i keshillit si dhe Gjyqtarët porot- A.M, dhe S.E dhe procesmbajtese L.T, duke vepruar sipas aktakuzes se PPTH nga Tetova KO.nr.348/17 te vj.3.10.2017, kundër të akuzuarit B.F, nga fshati R.V, për vepër penale të DHUNIMIT, sipas nenit 186.parag.1.lidhur me nenin 45 të Kodit Penal , në perputhje me nenet,32,33,35 dhe 39 te KP, pas mbajtjes së seancës kryesore, jo publike dhe gojore në prezencë të prokurorit publik B.I., të pandehurit dhe mbrojtësit e tij N.D.,NGA Tetova, gjykata solli këtë;

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI;

B.F I lindur me dt....., me vendbanim të përhershëm në fshatin RV, i martuar, baba i dy fëmijeve të mitur, i papunë, shqiptarë, shtetas i R.Maqedonisë është;

⁸⁹ Po aty

⁹⁰ R.Halili, Viktimiologjia, Prishtine, 2007, fq.151

F A J T O R

SEPSE;

Me date 10.7.2017, në peridhën kohore ndërmjet orës 01-05:00, në Tetovë me përdorimin e forcës dhe kërcënimit e ka detyruar në marrëdhënie seksuale personin M.I, nga Tetova. E dëmtuara është ofruar te shitorja ku ka qenë duke punuar i akuzuari dhe i ka kërkuar shkrepse. I akuzuari i është drejtuar viktimës me fjalët, hyr mbrenda ne shitore qe ta marrish shkrepse, me çka e dëmtuara ka hyrë mbrenda në shitore, me çka i akuzuari e ka mbyll derën me çels dhe e ka urdhërua që të zhvishet, duke iu drejtuar me fjalët zhvishu ma shpejt që të mos ndërmarë unë masa, dhe meqë e dëmtuara nuk veptoi sipas kërkesës së tij, i akuzuari e nxorri thikën dhe e zhveshi me dhunë kundër vullnetit të saj, pra kundër vullnetit të të dëmtuarës.

Me veprimet e mësipërme i pandehuri M.I. ka kryer veprë penale DHUNIMI të nenit 186 parag.2 dhe nenit 45 të Kodit Penal, kështu që gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të cituara nga nenet 32, 33, 35, dhe 39, të Kodit Penal, gjykata te akuzuarin e :

D E N O N

ME DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ-3 – VJET

Koha e kaluar në paraburgim që nga 10.07.2017 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit të llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ne perputhje me n.100-a te KP, thika do te merret si mjet i përdorur për kryerjen e veprës penale.

E dëmtuara M.I, lidhur me kërkesën eventuale për dëmtim udhëzohet në procedurë kontestimore.

A R S Y E T I M

I Akuzuari B.F nga fsh.RV, gjatë procesit gjyqësor, pas udhëzimit për të drejtat e tij si i akuzuar në procesin gjyqësor, u deklarua se e kupton aktakuzën në terësi

I akuzuari e pranoi fajin .

Procesmbajtëse;
L.T

Kryet.i këshillit-gjykatësi
S.I

KESHILLA: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga marja e të njëjtit.

5. Roli i Qendrës për Punë Sociale në parandalimin e veprave penale të dhunimit

Qendra për Punë Sociale në kuadër të kompetencave të punës së saj bën pjesë në kuadër të Sektorit të Mbrojtjes Sociale pranë Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale. Në përputhje me rregulativën ligjore, Qendra për Punë dhe Politikë Sociale funksionon si ent profesional me autorizime publike me qëllim të kryerjes së punëve nga fusha e mbrojtjes sociale.⁹¹

Në bazë të ligjit Qendra për Punë Sociale në Tetovë ka autorizime që ti kryej këto aktivitete dhe obligime të punës;

- preventive sociale,
- punë nga sfera e familjes,
- veprimtari nga fusha e mbrojtjes së fëmijëve,
- vepron në bazë të situatave nga sfera e të drejtës penale;
- mban evidencë për personat shfrytëzues të mbrojtjes sociale;

-Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj si dhe me programin e punës së Qeverisë së R.Maqedonisë, Vendimeve të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale si dhe me aktet e përgjithëshme të Qendrës.⁹²

⁹¹ Centar za socialna rabota-mtsp.gov.mk

⁹² Po aty

Nga të dhënat e marra nga evidencat e Qendrës për Punë Sociale, pasqyrohen llojet më të përhapura të abuzimit seksual te vajzat dhe djemtë. Të dy gjinitë janë viktimat të veprës penale të sulmit seksual ndaj të miturit më të ri se 14 vjet. E ngjashme është edhe gjendja e viktimave të veprës së incestit. Në shtatë prej tetë rasteve, viktimat të këtyre veprave janë vajza.⁹³ Ndonëse vajzat janë më të përfaqësuara si viktimat të regjistruara në numrin e përgjithshëm të fëmijëve viktimat të abuzimit seksual, megjithatë djemtë e vegjël të moshës nën 6 vjeç janë më shpesh viktimat të abuzimit seksual në krahasim me femrat e kësaj moshe: 24% e djemve përballë 4% e vajzave. Më tej, me rritjen e moshës (pas moshës 10 vjeç) rreziku i abuzimit seksual rritet te vajzat. 77% e të gjitha vajzave janë më të moshuara se 10 vjet, ndërsa 57% e të gjitha viktimave djem janë të moshës deri në 10 vjet.⁹⁴

⁹³ Po aty. fq. 28.

⁹⁴ Blerta Ahmedi, Punim magjistrature.

Përfundimi

Vepra penale e dhunimit është vepër e rëndë, pasi kryhet me anë të kanosjes dhe të dhunës kundër vullnetit të personit të dhunuar, pra, duke mos e përfillur vullnetin e viktimës dhe duke e kryer aktin seksual. Pra, për të ekzistuar kjo vepër penale, duhet që të mos ekzistojë pëlqimi i viktimës për akt seksual.

Vepra penale e dhunimit kryhet vetëm me dashje. Kryerës i veprës mund të jetë çdo person i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm, pa marrë parasysh perkatësinë gjinore, statusin martesor, jashtëmartesor etj.

Gjatë hulumtimit të kësaj teme të magjistraturës kemi konstatuar se gjatë periudhës 2012-2017 në rrethin e gjykatës themelore janë kryer gjithsej 17 vepra penale të dhunimit, prej të cilave në 12 raste është shqyptuar aktgjykim dënues.

Forma më e rëndë e kësaj vepre penale kryhet në rastet kur kryhet vepër penale e dhunimit me persona nën moshën 14 vjeçare, si dhe në rastet kur përdoret arma ose mjetet tjera të rezikshme, në rastet kur vepra është kryer në bashkëpunim me më shumë persona, në rastet kur vepra është kryer duke shkaktuar vdekjen e viktimës me anë të drogave të ndryshme apo me anë të alkoolit. Poashtu formë e rëndë e veprës penale të dhunimit, konsiderohret edhe në rastet kur kryerësi është në mardhënie familjare me viktimën, apo nëse kryerësi është mësues, apo person të cilit i është besuar rritja, person fetar etj.

Politka ndëshkimore e gjykatës themelore në Tetovë për të gjitha rastet e kryerjes së veprës penale të dhunimit nuk ka qenë e ashpër, por përkundrazi ka qenë e butë, kur kemi parasysh se gjatë vitit 2012 është shqiptuar nga ana e gjykatës edhe aktgjykim lirues në 1-një-raste.

Me qëllim të parandalimit të kësaj vepre penale ndaj kryerësve të përgjegjshëm të veprës penale të dhunimit duhet të shqiptohen dënime më të ashpra dhe çdo herë në maksimumin ligjor që parashihet në Kodin Penal.

Rol të rëndësishëm në parandalimin e veprës penale të dhunimit duhet të luajnë përpos gjykatës, edhe policia, prokuroria, mjetet e informimit, organizimi i tryezave të rumbullakta, organizimi i seminareve etj.

Viktima të veprës penale të dhunimit në të shumtën e rasteve paraqiten personat e gjinisë femërore. Viktimave nga vepra penale e dhunimi, duhet tu mundësohet mbrojtje, duhet tu ofrohet strehim dhe ndihmë shëndetësore.

Bibliografia

- **Vllado Kambovski,**
E drejta penale (përkthim) Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2004
- **Vllado Kambovski,**
E drejta penal, Pjesa e posaçme, Shkup, 1998
- **N. Srzentić, & A. Stajić,**
E drejta penale (përkthim), Prishtinë, 1986
- **Franjo Bacic,**
Krivicno pravo, Zagreb, 1978
- **Bogdan Zlararic,**
Krivicno pravo, Zagreb, 1977
- **Ejup Sahiti & Ismail Zejneli,**
E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 2007
- **Ejup Sahiti & Ismail Zejneli,**
E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 2017
- **Ismail Zejneli,**
E drejta penale—Pjesa e posaçme (Cikël leksionesh), Tetovë, 2007
- **Ismail Zejneli,**
Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2010
- **Ismail Zejneli,**
Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë, 2018
- **Bistra Netkova & Ismail Zejneli,**
Trafikimi me njerez-aspekte juridike, Tetovë, 2007
- **Bistra Netkova & tjerë,**
Human Right and domestic violence, Tetovë, 2007
- **Ismet Elezi,**

Politika kriminale, Tiranë, 2006

- **Ismet Elezi,**
E drejta penale-pjesa e posaçme, Tiranë, 2004
- **Ismet Saliu,**
E drejta penale-pjesa e posaçme, Prishtine, 2009
- **Ragip Halili,**
Kriminologjia, Prishtinë, 2016
- **Ragip, Halili,**
Viktimologjia, Prishtinë, 2007
- **Ragip, Halili,**
Viktimologjia, Prishtinë, 2011
- **Ragip Halili,**
Kriminaliteti kundër martesës dhe familjes në KSA të Kosovës, Prishtinë 1987.
- **Edmond Dragoti,**
Psikologjia ligjore e krimit, Tiranë, 2007;
- **Vesel Latifi,**
Kriminalistika, Prishtinë, 2011;
- **Vesel Latifi,**
Politika kriminale, Prishtinë, 2008
- **Vesel Latifi,**
Pozita e femrës si viktimë dhe deshmitare, kumtesë në tryezeë”Siguria dhe mbrojtja e viktimave”, Prishtinë, 2006
- **Vasilika Hysi,**
Kriminologjia, Tiranë, 2005
- **Alija Ramljak,**
Viktimologjia, Sarajevë, 2004
- **Skender Begeja,**
Kriminalistika, Tiranë, 2004
- **Ingrid Ramberg,**

Dhuna ndaj Grave të reja në Evrop, Këshilli i Evropës, 2001.

- **Ejup Sahiti dhe Rexhep Murati,**
E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013.
- **Agim Ramadani,**
Mjekësia Ligjore, Tetovë, 2015.
- **Lekë Sokoli,**
Prostitucioni si profesion, Tiranë; 2007
- **Mladen Milosavlječić,**
Seksualno nasilje nad djecom, Sarajevo, 2000;
- **Borislav Perovic,**
E drejta penale, Sarajevo, 2006
- **Bajram Yzeiri,**
Menaxhimi i policies, Tirane, 2003
- **Albert Dervishi**
Policia perballe realitetit, Tirane, 2003
- **E. Miftari,**
Këqyrja e vendit të ngjarjes, Tiranë, 1996
- **F. Henriques,**
Historija Prostitucije, Zagreb, 1968
- **S. Taseva,**
Temna brojka na kriminalitetot, Kocani, 1995
- **Kaizer.G,**
Kriminologjia, Shkup, 1996
- **Veton Vula,**
Kriminaliteti kompjuterik, 2010

Burime tjera:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, .
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë,
- Kodi penal i Republikës së Kosoves,
- Kodi penal i Republikës së Shqipërisë,.
- Ligji i procedurës penale i Republikës së Maqedonisë,
- Komentari i Kodit Penal të Kosoves, Prishtinë, 2014
- Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimet seksuale
- Ligji mbi drejtësinë për të mitur i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e R.M-së”, nr.87/2007.
- Ligji mbi të drejtat e fëmijëve i R.Maqedonisë, (Gazeta zyrtare nr.143, viti 2013)
- Centar za socialna rabota-mtsp.gov.mk
- Statisticki pregled, 2.4.17.09(878)
- Raport vjetor, i avokatit të popullit, Shkup, 2014